

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7805 E mërkurë 27 Shkurt 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Dje** *në* Deutsche Welle

**Kur skandalet në një vend plasën në mënyrë periodike, kur akuza për afëra të larta korruptive mbushin kryetitujt e mediave, por në fund i lihen harrimit e jo marrjes...** *Vijon në faqen 20*

Nga LINDITA ARAPI

**Kur meritokracia zëvendësohet nga paraja ose partia**



**Opinion** *i* **Ditës**

Nga FATOS ÇOÇOLI

**Do kemi një buldozer të dytë?**

**Shqipëria është në vëmendjen e Shtuar të Bashkimit Evropian, me dorëheqjen masive të opozitës (pakicës) sonë nga e drejta për përfaqësim të votuesve të saj në jetën...** *Vijon në faqen 21*

Nga FATOS ÇOÇOLI

**Do kemi një buldozer të dytë?**



Tokat e zëna nga ndërtimet pa leje

## ATP çel fondin, si ndahen 2.5 milionë euro për pronarët, emrat që përfitojnë

Shpërndahen 1 mln euro shtesë për familjet që kanë kërkuar kompensim të përsheptuar

Agjencia e Trajtimit të Pronave ka përfunduar procesin A e shqyrtimit për 141 kërkesa të paraqitura nga subjektet përfitues, pronarë të pasurive të paluajtshme, pronë private, të prekura nga ndërtimet informale. Pronarët përfitojnë deri më tani kompensimin në vlerë, në masën 70% të shumës së përgjithshme...

Në faqen 7

## OPOZITA PROTESTON, DIGJEN GOMA: "RAMA IK" DHE "POSHTE KOMUNIZMI" "BETEJE" PARA KUVENDIT, 3 ORE FLAKE E PERPLASJË

Basha: Policia bandë kriminale, mosbindje civile nga jugu në veri. Kryemadhi: Hajdutët kanë frikë. Rama: Do e vazhdoj kontratën me votuesit deri në fund



(Në foto) Protesta e djeshme e opozitës para parlamentit



Në faqet 2-3

**LISTA EMERORE**

**Të përndjekurit, dokumentet që mungojnë në dosjen e çdo aplikanti**

*Në faqet 10-12*

**SHKODER**

**Vranë të riun pas sherrit për kapele, dënohen me 20 vite burg dy autorët**

*Në faqen 8*

**CERTIFIKATE E PRONESISE**

**Drejtori i ZRPP: 31 mijë ndërtime marrin hipotekën brenda korrikut**

*Në faqen 6*

**SHOWBIZZ**

**VIP-at kosovarë që kanë marrë nënshtetësi të Shqipërisë**

*Suplement*

**KREU I GRUPIT TE PS**



**Balla në "News 24": PS nuk blen vota, Dako meriton të kandidojë sërish**

*Në faqen 4*

In memoriam/ Fotografitë e rinisë, mesazhet dhe homazhet e miqve të familjes

## Shuhet Sadije Agolli, historia e njohjes me Dritëroin

Malli për bashkëshortin dhe plani që la në mes, vdes e veja e shkrimtarit

Nga FATMIRA NIKOLLI

Unë e kam ndierë shumë mungesën e tij, do doja që të kisha mendimin e tij. Për çdo gjë unë flisja me të". Vetëm në fillim të muajit, Sadije Agolli, e veja e shkrimtarit Dritëro Agolli fliste kështu për mallin 2-vjeçar



për të shoqin. Në përvjetorin e ikjes së tij, ajo ndjente se kjo mund të ishte intervista e saj e fundit dhe "linte amanet", që shtëpia e tij të kthehej muze, siç parashihte një projekt i Bashkisë së Tiranës. I ishte dashur shumë kohë të pranonte...

Në faqen 18

# KRIZA POLITIKE PROTESTA

Kreu i PD: S'frikësohemi, Rama urdhëroi sulmin kimik, do shembim republikën e krimit

## Basha: Policia bandë kriminale, mosbindje civile nga jugu në veri

### "Nuk e njohim as policinë e krimit"

Valentina Madani

Lideri i opozitës, Lulzim Basha, paralajmëroi mbremë mosbindje civile nga jugu në veri kundër qeverisë. Pas rreth tri orëve protestë, kreu i PD-së, Lulzim Basha, mbajti një fjalim pranë selisë së partisë që drejton duke theksuar se pas qeverisë dhe parlamentit, opozita nuk njeh më as policinë. Duke e konsideruar 'Maduron e Ballkanit', Basha i tha kryeministrit Rama se zot i këtij vendi janë qytetarët. "Protestues, mos ulni kokën dhe të pranoni fatin e skllavit që pasi vidhet, dhunohet. Jeni ngritur për të mos u ulur më deri në fitoren totale të lirisë dhe demokracisë mbi bandën kriminale, që kanë marrë peng Shqipërinë. Si minj u mblodhën sot (dje) duke shpresuar se tinëzishit do t'ia hidhnin popullit. Falënderoj qindra e mijëra qytetarë që brenda pak orëve u mblodhën si asnjëherë për t'i treguar Maduros së Ballkanit që ky vend ka zot dhe zoti janë qytetarët. Dhi Rama përdori dhunën ndaj qytetarëve që protestonin në paqe. Sot, ne nuk kemi më Kuvend, nuk kemi më qeveri dhe për fat të keq nuk kemi as polici. Kemi një bandë kriminale dhe hajdutësh që kanë vjedhur Shqipërinë", - tha z.Basha. Më tej, ai përcolli mesazhin: "Ne nuk njohim më jo vetëm qeverinë e krimit, por edhe policinë e krimit. Mosbindja civile do të shtrihet nga jugu në veri dhe do ta çlirojim këtë vend. Çdokush me uniformë, me syze analisti apo kostum oligarku që është pranë kësaj bande, është tradhtar i popullit të vet, është tradhtar i interesave të qytetarëve të thjeshtë dhe do të trajtohet si tradhtar i qytetarëve



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dje në protestën e opozitës

#### DEKLARATA



#### PETRIT VASILI

"Këtu është populli, këta i janë fshehur popullit, të fshehur pas fustanit të Gramoz Ruçit. As te fustani të Ruçit, as te brekushet e Edi Ramës nuk i shpëton dot rjeri. Populli do ta pastrojë atë parlament nga ata minj që e kanë qelbur dhe e kanë ndyrë. Asnjë hap pas derisa Rama jo të ikë, por të shporret!", tha z.Vasili.



#### TRITAN SHEHU

"Një parlament që thërrret seancat plenare si në ilegalitet, jashtë kuadrit të rregullores e traditës, pa dyshim është 'nul'. Deputetët që kthehen në thjesht 'robot' që pranojnë t'u bëhet 'reshitore' sikur të ishin zboristët e dikurshëm. Pa dyshim nuk mund të kryejnë funksionet e tyre", tha z.Shehu.



#### PARALAJMËRIMI

"Protestues, mos ulni kokën dhe të pranoni fatin e skllavit që pasi vidhet, dhunohet. Jeni ngritur për të mos u ulur më deri në fitoren totale të lirisë dhe demokracisë mbi bandën kriminale që kanë marrë peng Shqipërinë. Si minj u mblodhën sot (dje) duke shpresuar se tinëzishit do t'ia hidhnin popullit", tha z.Basha.



Protesta e djeshme para Parlamentit

#### MEDIU: TË SHEMBIM MURIN QË NDËRTOI RAMA

Kreu republikan, Fatmir Mediu, ftoi dje qytetarët shqiptarë që të shembin murin e ndërtuar nga kryeministri Rama për t'i hapur Shqipërisë rrugën drejt BE-së. "Njerëz që besuan të liria dhe duan të ndërtojnë ëndërrën evropiane, por për fatin e keq është ndërtuar një mur i madh nga Edi Rama. Janë të gjithë shqiptarët që po vuajnë dhunën, varfërinë e këtij pushteti. Është në dorën tonë ta shembim këtë mur të fëlliqur mes nesh", theksoi z.Mediu.

## Kryemadhi: Hajdutët kanë frikë, çdo ditë do të rrethojmë parlamentin

Nga protesta para Ku vendit, kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi deklaroi se misioni kryesor i politikës është largimi i fenomenit Edi Rama, që ka vrarë shpresën e shqiptarëve. Kryemadhi deklaroi se Kuvendi do të rrethohet çdo ditë që mazhoranca do të vazhdojë ta mblodhë në ilegalitet. "Hajdutët kanë frikë dhe sot frikacakët përdhosën për të disatën herë selinë e Kuvendit, që për hir të së vërtetës parlamentarë nuk kanë frikë nga populli i tyre, por e përfaqësojnë atë. Ata treguan se nuk janë përfaqësues të popullit, por Barajve, Habilajve.



Sot tregoi që është parlamenti që punon për 5 veta. Nuk mbetet gjë tjetër për të thënë veçse Rama ik! U drejtohem socialistëve të ndershëm që vuajnë njësoj, prezenca jonë nuk është vetëm për sot, por çdo ditë që ajo seli e parlamentit që në

çdo moment ka qenë foltorja e fjalës së lirë në këto 27 vjet, nuk do të jetë e lirë nga rrethimi që populli do t'i bëjë asaj. Ne do ta rrethojmë çdo ditë që ata do të duan të bëjnë seancat e krimit të organizuar në parlament", u shpreh zj.Kryemadhi.

të thjeshtë. Të bashkuar si asnjëherë, demokratë dhe socialistë, myslimanë dhe të krishterë vazhdojmë rrugën tonë drejt demokracisë evropiane". Më herët, në nisje të protestës para Kuvendit, kreu i PD-së u bëri dje thirrje punonjësve të policisë të rreshtuar përpara parlamentit, që të arrestojnë deputetët e inkrimnuar të mazhorancës. Gjatë fjalimit

të shkurtër në protestën e opozitës, Basha apeloj se policët duhet të heqin kapelat dhe të bëjnë detyrën e të respektojnë Kushtetutën dhe ligjin. Sipas Bashës, protestat do të vazhdojnë deri në largimin e kryeministrit Edi Rama. "Ky është një bashkim që do çlirojë udhëtimin evropian të Shqipërisë, do çlirojë edhe socialistët e ndershëm nga banda kriminale e

Edi Ramës. Vëllezër dhe motra me uniformë, ju qëndroni mes hajdutëve dhe kriminelëve në atë godinë dhe popullit të vjedhur në anën tjetër: Bëni detyrën, hiqni kapelën, arrestoni hajdutët dhe nxirrini me pranga në duar. Arrestojini, bëni detyrën tuaj përpara Kushtetutës dhe ligjit, arrestojini përpara se t'ju arrestojë populli i bashkuar: Edi

#### IDRIZI, RAMËS: BURRAT E LËNË PUSHTETIN, DIKTATORËT RREZOHEN

Kreu i PDIU-së, Shpëtim Idrizi, gjatë fjalës në protestë i kujtoi Edi ramës se diktatorët rrezohen nga pushteti. "Shqiptarët sot jetojnë në një moment të jashtëzakonshëm. Kuri janë vjedhur zgjedhjet, u vidhet jeta. Shqiptarët janë të detyruar të braktisin Shqipërinë. Sot 2.2 miliardë euro të taksave të shqiptarëve vidhen nga 5 veta. Janë pikërisht këto arsye që detyruan opozitën shqiptare të mos jetë në atë parlament të ngjuar të rrethuar me tela. Burrat dinë ta lënë pushtetin, diktatorët rrezohen nga pushteti. Ikin dhe kërkojnë strehim politik si Gruevski. Sot shqiptarët duan zgjedhje, duan demokraci, duan liri", deklaroi z.Idrizi.

Rama është shkaktri i varfërisë, i mjerimit dhe varfërisë. Me Edi Ramën nuk do të ketë as zhvillim, as integrim, por vetëm betejë të përditshme dhe të përnatshme deri në largimin e kllikës mafioze. Parlamenti i krimit ka marrë fund përgjithmonë", theksoi z.Basha. Sipas tij, populli ka nisur betejën për fatin evropian të vendit.

REDAKSIA: Redaktor i Suplementeve dhe Sociales: Rezarta Delisula, Redaktor i Rretheve: Trëndafilë VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.

ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Ltaqa Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0688087823-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës

së Autotrajektorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik"Shpk



**Policia**

Një kordon policie i përbërë nga dhjetëra efektivë bllokoi dje hyrjen kryesore të parlamentit, ndërsa mësohet se në total, u angazhuar rreth 1 mijë Forca të Ndërhyrjes së Shpejtë, të RENEA-s, Shqiponjave dhe nga Garda e Republikës.

**Shihedhësja**

Përveç gazit lotsjellës, policia nxori në terren edhe një shihedhëse por që nuk u përdor nga forcat e rendit. Protesta e djeshme u shoqërua me disa momente tensioni dhe përplasje me policinë.

**Akuza**

Albana Vokshi akuzoi z.Rama se ka urdhëruar hedhjen e lendeve luftarakë helmuese mbi protestuesit. Sipas saj hedhja e lendeve helmuese ka bërë që nxënësit e shkollës profesionale të braktisin mësimin pasi u mbyten nga gazit lotsjellës. Ajo e konsideroi skenë të tmerrshme daljen jashtë të nxënësve të mbytur nga lënda e hedhur në proteste nga policia.

Valentina Madani

Opozitarëve iu deshëm pak orë përgatitje dhe brenda një kohë të shkurtër ata u bën me qindra pasditën e djeshme në orën 17:00 para godinës së Kuvendit. Pavarësisht ndryshimit të orarit të seancës plenare e parashikuar për t'u mbledhur ditën e enjte në orën 10:00, opozitarët ishin të shumtë në protestën e djeshme. Paralelisht me zhvillimin e seancës, protestuesit për tri orë me radhë bënë thirrje kundër qeverisë, duke hedhur shashka e flakadanë në drejtim të kordonit policor. Policia mbrojti Kuvendin me gazlotsjellës ndërkohë që në oborrin e parlamentit u dogji dhe një gomë si dhe një fotografi e Ramës që ngjan me presidentin venezuelian Maduro. Protestuesit e opozitës hodhën kapsolla dhe tymuese përpara selisë së parlamentit, duke tensionuar herë pas here situatën. Protestuesit kënduan një këngë në kor "Edi Rama ka maru, ka maru...". "Liri demokraci" dhe "E duam Shqipërinë si gjithë Europa" ishin thirrjet që dominuan në protestën e opozitës para Kuvendit mes djegies së gomave, kapsollave dhe tymueseve të hedhura nga protestuesit. Një tjetër thirrje ishte dhe "Këtu vendosim ne!". "A e dini se me çfarë ia u kemi vendosur flakën e atyre gomave, me votat e blera të këtyre. Ai është parlament i legjimit, ky është parlamenti. Rama ik! Rama ik!" dëgjohej zëri i një prej organizatorëve që dirigjonte protestuesit. Nuk munguan as thirrjet fyese në kor për Kryeministrin: Edvin, hajdut, kazan, legen. Protestuesit kënduan këngë patriotike ndërsa thirrën: Poshtë komunistizmi... "Rama ik", "E duam Shqipërinë si gjithë Europa" ishin thirrjet nga protestuesit të cilat kulmuan me thirrjen "O dorëzohu, o rrëzohu!"

**PËRPLASJA**

Protestuesit tentuan të çajnë kordonin e policisë për të hyrë në Kuvend, por policia hodhi gaz lotsjellës për të zbrapsur tërësisht nga sheshi para parlamentit. Në momentin kur protestuesit çanë kordonin e parë të policisë, u përdor gaz lotsjellës për t'i larguar. Më pas efektivet e RENEA-s që ndodheshin disa metra më tutje, si kordon i dytë, kaluan në kordon të parë. Sheshi përpara parlamentit për pak çaste u boshatis ndërkohë që dëgjoheshin thirrjet e policisë me megafon distancuani. "Policia do të zbatojë ligjin". Vetë kreu i opozitës Lulzim Basha hyri mes protestuesve që po tentonin të

Para parlamentit hidhen kapsolla dhe digjen goma: Rama ik! Poshtë komunizmi

# Opozita tri orë protestë, policia mbron Kuvendin me gaz lotsjellës

Protestuesit "shtynë" Klosin, Sterkaj hyn mes tymueseve

**SPEKTAKLI**

Momentet e tensionuara të protestës së opozitës para Kuvendit me goma të djegura, kapsolla dhe tymuese ia lanë vendin edhe shfaqjeve të spektaklit. Siç ndodh rëndom në koncerte që kryesisht mbahet në oraret e darkës, në një moment të gjithë protestuesit u ftuan të zbehnin errësirën me dritat e tyre të telefonit duke ofruar skena show.



**MONITORIMI**

Turma e protestuesve u shpërnda nga hedhja e gazit lotsjellës nga policia, para derës së Kuvendit u shfaq ish-Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj, duke monitoruar situatën nga larg. Ngjitur me të tre persona të tjerë nxituan të bëjnë një selfie. Më pas krahu Xhafaj u shfaq dhe deputeti socialist, Fate Velaj.



Protesta, OSBE: Dhuna nuk zgjidh problemet e Shqipërisë

Reagimi i parë nga Ndërkombëtarët sa i takon dhunës dhe përplasjeve para parlamentit dje erdhi nga OSBE. Përfaqësia e OSBE në Tiranë deklaroi se dhuna nuk është përgjigja për problemet e Shqipërisë. OSBE dënon sërish nxitjen politike të dhunës dhe bënë thirrje për vetëpërmbytje dhe përgjegjësi. "Të protestuarit është një akt demokratik, por djegia e gomave, përdorimi i shashkave dhe çarja e kordonëve të policisë për të sulmuar një institucion publik, dhe veçanërisht zemërimi dhe demokracisë, nuk janë të tillë. Po ashtu, e nximis policinë të reagojë në mënyrë përpjestimore. Ne po e monitorojmë situatën me shqetësim. Përgjegjësi mediat për shërbimin e madh që po bëjnë demokracisë përmes raportimeve të drejtpërdrejta", thuhet në reagimin e OSBE-së.

## Paloka: Ose do të ulim kokën dhe të bëhemi skllëvër të Edi Ramës

Nënkryetari i PD-së Edi Paloka deklaroi përpara protestuesve se kryeministri Rama është frikacak dhe se mendoi që sot do ta gjente opozitën të pa përgatitur. "Mendoi sot, ashtu siç mendon ti, frikacak, se duke u fshehur siç bën gjithmonë, do ta gjenit të papërgatitur, ja ku jemi këtu sot dhe këtu do jemi çdo ditë. Ata në parlament nuk përfaqësojnë më shqiptarët dhe as ata që e kanë votuar. Ai parlamenti, është parlamenti i krimi dhe i blerë me votat e tyre. Sot edhe ata që janë brenda, një pjesë e tyre, sepse një pjesë janë plehra si Edi Rama, janë kokullur. Ne vazhdojmë të qëndrojmë këtu, por ata shtynë fjalimet se nuk kanë



çfarë të bëjnë tjetër. Ne jemi këtu për të treguar se shqiptarët janë ngritur në revoltë. Nuk ka një grup njerëzish që protestojnë për Partinë Demokratike, janë shqiptarët në revoltë. Këtu

janë shqiptarët që po varfërohen përditë. Sot jemi në rrugë për mbijetesë, ose do të rezistojmë, ose do të ulim kokën dhe të bëhemi skllëvër të Edi Ramës", theksoi z.Paloka.

çanin kordonin e policisë duke u bërë thirrje që të ruanin qetësinë. Por mbi protestuesit u hodh sërish gaz lotsjellës këtë herë për t'i zbrapsur me tutje protestuesit. Ndërkohë ish-ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj nga dera e parlamentit pa se çfarë po ndodhte pak metra me tutje tek dera e Kuvendit.

Protestuesit ndjenë shqetësimet e gazit lotsjellës ndërkohë që kryetarja e LSI-së Monika Kryemadhi e quajti një turp hedhjen e gazit lotsjellës duke i garantuar qeveritarët se opozita do të jetë sërish në protestë. "Turp më të madh nuk ka duke hedhur gaz lotsjellës mbi qytetarët e Tiranës. Hidhni gaz lotsjellës

sa të doni, por jo kurrë nuk do të ndaloni dot urrëjtjen që kanë krijuar qytetarët për qeverinë e Dakos, Avdyllajve, etj.. Boll vazhduat me këtë mënyrë. Ne prapë do të vijmë këtu, por ju nuk do të ndaloni dot mallkimin e shqiptarëve", tha zj.Kryemadhi. Ndërsa kreu i opozitës Lulzim Basha mori megafonin dhe

këndoi: "Eja mblidhuni këtu, këtu bashkë me ne...". Basha akuzoi më tej se: "Edi Rama, Sandër Lleshi dhe të gjithë ata që në mënyrë të paprovokuar urdhëruan goditjen me gaz të nënave dhe grave. Mos prekni qytetarët!". Protestuesit u ulën këmbërq në sheshin para parlamentit dhe thërrisnin: Rama ik!

**INCIDENTI**

Deputetët socialistë shfrytëzuan hyrjet anëse të ndërtesës së parlamentit për të hyrë në seancën plenare. Nga ana tjetër, forcat e rendit u bënë "gardh" përpara protestuesve. Ministri i Mjedisit, Blendi Klosi është përplasur me protestuesit e opozitës dhe në një moment, ata e kanë shtyrë. Ministri është hedhur nga muret antike duke kaluar në anën tjetër, ndërsa ndiqej nga protestuesit. Protestuesit e opozitës tentuan të pengonin ministrin e Mjedisit Blendi Klosi që mos të hynte në parlament. Ministri Klosi u sulmua nga disa protestues të mbledhur përpara godinës së parlamentit. Edhe deputeti socialist, Paulin Sterkaj është përplasur me protestuesit e opozitës. Në mes tymueseve, Sterkaj kaloi për të hyrë në parlament. Është dashur ndërhyrja e forcave të rendit për të penguar përplasjen e mëtejshme. Protestuesit nuk trazuan deputetet e PS-së, të cilat kaluan të pa shqetësuar afër protestuesve të shumtë.

# SEANCA MANDATET

## Ballë: PS nuk blen vota, Vangjush Dako meriton të rikandidojë sërish

Kryetari i Grupit Parlamentar socialist ka hedhur poshtë akuzat e opozitës se Partia Socialiste ka blerë votat në zgjedhjet e 2017. Përbalë një paneli gazetarësh në emisionin "Dritare me Rudinën" në News24, ai komentoi zhvillimet e fundit politike në vend, ndër-samohoi që PS të ketë blerë vota. "Unë deklaroj me përgjegjësi se Partia Socialiste e Shqipërisë nuk blen vota", - tha Ballë. Sipas tij fenomeni i blerjes së votave ekziston në Shqipëri, por se ai nuk ka ndikuar në rezultatit të zgjedhjeve. Ndaj duke rrëzuar këtë pretendim të opozitës ai në mënyrë të prerë theksoi se kërkesa e saj për krijimin e një qev-



erie tranzitore që do organizojë zgjedhjet e parlamentare dhe ato vendore nuk do të pranohet. "Nuk pranohet kërkesa e Lulit, Monikës dhe babë Saliut që ne të heqim

dorë nga kontrata me shqiptarët", - u shpreh Balla. Sa i përket protestës së djeshme ai theksoi se opozita po vetëgjësohet, ndërsa akuzoi PD-në se kishte furnizuar disa nga mbështetësit e vet me bomba artizanale molotov dhe se ka angazhuar element me precedent kriminal. "PD ka furnizuar protestuesit me mjete që rrezikojnë jetën e punonjësve të policisë së shtetit. Sot është parë në oborrin e PD-së që protestuesit mbushnin bidonë me benzinë", - tha Balla. Gjithashtu, ai hodhi dyshime se protesta e opozitës ndikohet nga Rusia. "Lulzim Basha është përsëritës i një marrëdhënie të dyshimtë me rusët. Sigurisht nuk është e rastësishme dhe disa element nuk janë të rastë-

sishëm. 16 shkurti ishte programuar edhe këtu edhe në Podgoricë", - deklaroi Balla. Më tej kreu i deputetëve socialistë theksoi se arsyet e protestës dhe djegies së mandateve të deputetëve opozitar, lidhen me faktin se opozita nuk arrin dot të fitojë zgjedhjet. Ai foli për sondazhe që e nxjerrin PD-në se gëzon mbështetjen e 20 për qind të shqiptarëve. "Sot PD, nga sondazhet që bën edhe vet PD mezi përpilletet te 20 për qindësi i mbështetjes", - deklaroi Balla. Duke u ndalur te çështja e zgjedhjeve vendore të 30 qershorit, ai u shpreh se Vangjush Dako meriton një mandat tjetër. "Unë e them sërish që Vangjush Dako ka bërë një punë që meriton të rizgjidhet", - deklaroi ai.



Deputetët votuan edhe dy ligje që i japin zgjidhje regjistrimit të tokave

# PS mbledh Kuvendin në befasi, votohet mes tensionit struktural e KLGJ dhe KLP

"Kush mendon se s'do ketë zgjedhje në 30 qershor, gabon"

Kuvendi i Shqipërisë ka mundur dhe të mbaj mes tensionit që shkaktoi protesta e opozitës, seancën e plenare, ku ndërmjet të tjerave miratoi edhe strukturat e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Pavarësisht se mazhoranca u mundua të kapë në befasi opozitën, duke vendosur që të thërrasë mbledhjen seancës plenare të Kuvendit vetëm dje paradite, partitë opozitare arritën që të organizojnë një protestë që vuri jo pak në vështirësi, si forcat e policisë që duhet të ruanin rendin, ashtu edhe deputetët dhe ministrat socialistë që në disa raste u vunë në vështirësi nga protestuesit teksa hynin në sallë.



Presidenti Meta vlerësoi drejtorin e Fondacionit "Konrad Adenauer" në Shqipëri, Walter Glos me dekoratën "Për Merita të Veçanta Civile". Meta i dorëzoi dekoratën zotit Glos, në përfundim të mandatit të tij, me motivacionin: "Në vlerësim të kontributit të çmuar për forcimin e marrëdhënieve dypalëshe ndërmjet Shqipërisë dhe partnerit të saj strategjik Gjermanisë, si dhe për promovimin e vlerave dhe standardeve europiane në vendin tonë".

**SEANCA**  
Pa praninë e opozitës, e cila tashmë ka dorëzuar mandatet e deputetëve, shumica e majtë mboldhi dje paradite në mënyrë formale Konferencën e Kryetarëve, ku vendosi ndërmjet të tjerave të thërrasë për pasditen e djeshme seancën plenare. Një lëvizje kjo që kërkoi të shmangë praninë e madhe të protestuesve të opozitës dhe një përshtakëzim të situatës. Menjëherë pasi Kuvendi lajmëroi në media thirrjen e seancës, reaguau edhe partitë opozitare, të cilat e konsideruan thirrjen e Kuvendit në seancë plenare ilegjitime. Ndërkohë që menjëherë ato i bënë thirrje të gjithë

mbështetësve që të mbështesnin protestën që do të organizohet në mbrëmje. Por ndërsa mazhoranca përgatiste mbajtjen e seancës dhe opozita organizimin e protestës, forcat e shumta të policisë morën masat për të evituar hyrjen e protestuesve brenda parlamentit. Por pavarësisht këtyre masave disa nga deputetët dhe ministrat socialistë e patën të vështirë të hyjnë në sallë, pasi protestuesit kishin bllokuar dy hyrjet e Kuvendit. Në disa raste, siç ishte ai i ministrit Blendit Klosi apo

edhe i deputetit Paulin Sterkaj nuk munguan edhe përplasjet fizike. Por ndërsa jashtë sallës tensioni rritej, kryetari i Kuvendit Gramoz Ruci hapi seancën duke njoftuar edhe kalimin e deputetit Dritan Bici të PDIU-së në radhët e PS-së. Ndërkohë që nga foltorja e Kuvendit, kreu i grupit parlamentar të PS, Taulant Balla u shpreh se me veprimet e ndërmarra kryedemokratit Basha, po krijon një precedent të rrezikshëm. "Me këto veprime Basha krijoi një precedent të rrezikshëm që çdo

opozitë të kërcënojnë me djegie mandateve nëse nuk i jepet pushteti në tavolinë. Harroje Lulzim", - u shpreh Balla, ndërsa theksoi se gabon, kush mendon se nuk do të ketë zgjedhje në 30 qershor. Ai garantoj se PS do e çojë mandatin deri në fund. "Ne jemi Partia Socialiste e Shqipërisë, jemi votuar për të plotësuar ëndërrën e shqiptarëve jemi mësuar me papërgjegjshmërinë e Bashës Berishës e Kryemadhit në 2017 morëm mandat të qartë e do ta çojë këtë mandat deri në fund në

## Rama nga Lushnja: Do e vazhdoj kontratën me votuesit deri në fund

Lushnja ka qenë ndalesa e radhës e turit të kryeministrit Edi Rama "Bashkia që duam". Pavarësisht përpjekjes së disa simpatizantëve të PD-së për t'i bllokuar rrugën, kryeministri ka zhvilluar një takim me banorët e qytetit të Lushnjës ku ka përsëritur se nuk do të tërhiqet nga pushteti pasi do të respektojë kontratën e bërë me qytetarët. Sipas tij opozita po vepron në këtë mënyrë, sepse nuk ka asnjë mundësi që të fitojë zgjedhjet vendore. Qeveria tranzitore sipas Kryeministrit nuk sjell asnjë garanci që opozita nuk do të ankimojë më pas procesin, siç bëri në zgjedhjet e shkuara. "Pikërisht, sepse erdhi dita të qeverisim me njerëzit dhe jo me partitë që pushtetin e njerëzve e kthyen në një tepsitë të madhe. Ne nuk mund të tërhiqemi nga ky detyrim. Mblodhëm parlamentin sot. Nuk duam konflikt, nuk duam përballje nga ato përballjet primitive që kanë ata në kokë dhe parlamentin i çliaruar më në fund prej tyre do të jetë vendi ku do të mund të flasin për ju", - tha Rama. Sipas Kryeministrit, opozita ankoher për rezultatit edhe pse ishte pjesë e qeverisë teknike në fushatë dhe gjatë zgjedhjeve të fundit. "Ai ishte apo nuk ishte një vit e gjysmë përpara ku u dhamë gjithçka kërkuan, morën gjysmën e qeverisë, Ministrinë e Brendshme. Pse ua dhamë ato? Vetëm për një qëllim, kush fiton qeveris dhe kush humbet bën opozitë", - u shpreh kryeministri. Kreu i qeverisë ironizoi opozitën teksa u shpreh se me protestën dhe dorëzimin e mandateve arriti të rrëzojë vetëm deputetin e Lushnjës Myslim Murrizin.



respekt të shqiptarëve e do fitojmë në 2021 një mandat të tretë se u kemi treguar se jemi besnik", - theksoi Balla.  
**VOTIMI**  
Pas gati 3 orë diskutime, Kuvendi kaloi në procesin e votimit, duke qenë se në sallë kishte 72 deputetë të mjaftueshëm për të bërë kuorumin e votave për një seancë legjitime. Ra në sy në këtë seancë mungesa e kryeministrit Rama, dy deputetëve të PDIU-së, dhe deputetëve të opozitës që nuk kanë pranuar të lënë mandatin. Kështu

Kuvendi votoi me 72 vota strukturat e KLGJ dhe KLP, të cilat do të kenë respektivisht 125 dhe 65 persona. Kuvendi votoi, gjithashtu, edhe ligjin "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfuttesve", si dhe ligjin "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore". Dy nisma këto që kërkohet t'i japin zgjidhje problemit të regjistrimit të tokës në fshat.



Bllokohet "hileja" e PS për të ndaluar rikandidimin e Xhelal Mziut dhe Fiqiri Ismailit

# Bie propozimi i PS-së, Zguri shpëton kryebashkiakun e Vorës dhe të Kamzës

Udhëzimi ndalon rikandidimin e kryebashkiakëve me 3 mandate

Kryetarët e bashkive që kanë më shumë se 3 mandate do kenë mundësi që të rikandidojnë në zgjedhjet parlamentare të 30 qershorit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk arriti dot dje që të miratojë një propozim të socialistëve, por të paraqitur nga administrata e tij, për të ndaluar rikandidimin për herë të katërt të disa kryetarëve aktualë bashkiakë, të cilët kanë aktualisht 3 mandate. Vendimi që prekte Qazim Sejdinin, Vangjush Dakon, Gëzim Topçiu dhe Adriatik Zotkaj në PS-së, Fiqiri Ismailin dhe Xhelal Mziun të PD-së, si dhe Shuaip Beqiri e PDIU-së ka marrë 4 vota pro të anëtarëve të zgjedhur me propozim të PS-së dhe votën kundër të kryetarit të KQZ-së, Klement Zguri. Por, pavarësisht se ka marrë 4 vota pro, propozimi nuk është miratuar. Kjo, pasi bëhej fjalë për një akt që vjen në formën e udhëzimit dhe që për t'u miratuar kërkonte 5 vota. Në këtë mënyrë, Klement Zguri me votën e tij kundër ka shpëtuar kryebashkiakët që kanë 3 mandate. Përfaqësuesit ligjorë të PD-së në KQZ e kundërshtuan nismën me argumentin se ligji i miratuar në 2015-en nuk mund të ketë efekt prapaveprues. "Ky akt është i bursur që para se të vinte në këtë tavolinë me sensibilitet politik nga një forcë politike. Nuk e ka këtë problem me të zgjedhurit e saj vendorë, pasi vetëm dy të zgjedhur vendorë, të cilët i ka



**OPOZITA**  
"Ky akt është i bursur që para se të vinte në këtë tavolinë me sensibilitet politik nga një forcë politike. Nuk e ka këtë problem me të zgjedhurit e saj vendorë, pasi vetëm dy të zgjedhur vendorë të cilët i ka përballen me probleme të tjera shumë më të mëdha që i lidhin ato drejtpërdrejtë me krimin e organizuar. Ligji nuk mund të ketë efekte prapavepruese", - tha Ivi Kaso.

## Djedia e mandateve, KQZ merr 10 ditë kohë për zëvendësimin e deputetëve

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka hapur procesin për plotësimin e vakancave të krijuara nga dorëzimi i mandateve të deputetëve të opozitës. Menjëherë pasi Kuvendi i Shqipërisë i ridërgoi edhe një herë dosjen me kërkesat për dorëheqje nga 57 deputetët e opozitës, KQZ ka nisur punën për shqyrtimin e tyre dhe zëvendësimin e tyre me kandidatë nga listat shumemërore të PD dhe LSI. Nëpërmjet një deklarate për mediat, zëdhënësja e KQZ-së, Drilon Hoxhaj bëri të ditur pas mbërritjes së kërkesave të Kuvendit për plotësimin e vendeve vakante, kanë vijuar procedurat e mëtejshme për plotësimin e tyre. "Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ju bën me dije se në KQZ ka mbërritur kërkesa e Kuvendit të Shqipërisë për plotësimin e vendeve vakante për 57 deputetë të dorëhequr", - tha Hoxhaj. Më tej, ajo u bëri thirrje të gjithë kandidatëve që janë në listat shumemërore të PD dhe LSI të paraqiten në KQZ për të plotësuar edhe një herë formularin e vetëdeklarimit të dekriminalizimit. "Ligji i kërkon KQZ-së që të kontaktojë kandidatët e listave respektive sipas radhës dhe t'u kërkojë atyre plotësimin e formularit të vetëdeklarimit pa të cilin nuk mund të marrin vërtetimin e zgjedhjes. Kandidatët e listës shumemërore kanë afat 10 ditë për dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit. Pas verifikimit dhe shqyrtimit nga administrata e KQZ-së, zëvendësimet e vakancave të krijuara do të kalojnë në mbledhjet publike të KQZ-së", - tha zëdhënësja e KQZ.

- KRYEBASHKIAKËT ME MË SHUMË SE 2 MANDATE**
1. Vangjush Dako (kryebashkiak i Durrësit).
  2. Qazim Sejдини (kryetari i Bashkisë Elbasan).
  3. Xhelal Mziu (kryetari i Bashkisë Kamëz).
  4. Gëzim Topçiu (kryetari i Bashkisë Maliq).
  5. Adriatik Zotkaj (kryetari i Bashkisë Polican).
  6. Edmond Themelko (kryetari i Bashkisë Pustec).
  7. Fiqiri Ismaili (kryetari i Bashkisë Vorë).
  8. Shuaip Beqiri (kryetari i Bashkisë Konispol).

## KIE: Opozita të rishikojë dorëheqjet nga Kuvendi, PS të dialogojë

Kriza politike që ka përfshirë Shqipërinë ka zbritur edhe në Asambleen Parlamentare të Këshillit të Europës. Bashkëraportuesit për monitorimin e Shqipërisë në këtë asamble, Andrej Hunko dhe Joseph O'Reilly, nëpërmjet një deklarate të përbashkët kanë shprehur shqetësim për heqjen dorë nga mandatet e deputetëve të opozitës. "Në një shoqëri demokratike, parlamenti është qendra e debatit politik, dialogut dhe balancimit të mendimeve. Parlamentarët i përkasin parlamentit", - thuhet në deklaratën e tyre. Duke përhëndur faktin se fundjavën e shkruar, protesta e opozitës u zhvillua në mënyrë paqësore, ata u kërkuar deputetëve të opozitës të rimarrin në konsideratë dorëheqjet e tyre dhe të kthehen të punojnë në parlament. Në të njëjtën kohë, ata i kërkuar mazhorancës në pushtet të garantojë hapësirën e nevojshme për opozitën që ajo të funksionojë dhe angazhohet në një dialog domethënës dhe të hapur me opozitën, në lidhje me reformat kyçe dhe qeverisjen e vendit. "Të dyja palët duhet të përdorin platformën e parlamentit për t'u angazhuar, në mirëbesim, në një dialog të tillë, në mënyrë që të kapërcehet mosmarrëveshja aktuale politike. Nëse kërkohet, ne jemi të gatshëm të ndihmojmë kolegët tanë nga të dyja palët në këtë përpjekje", thuhet më tej në deklaratën e përbashkët.



përballen me probleme të tjera shumë më të mëdha që i lidhin ata drejtpërdrejtë me krimin e organizuar. Ligji nuk mund të ketë efekte prapavepruese", - tha Ivi Kaso, përfaqësuesi i PD-së në KQZ. Por, përfaqësuesi ligjor i PS në KQZ, Eridian Salianji theksoi se ky propozim është mbështetur të detyrim ligjor dhe se ai prek më shumë kryetarë bashkish socialistë se sa demokratë.

"Janë më shumë kryetarët e bashkive të PS që u kufizohet kjo e drejtë për të rikandiduar sesa PD-së, por ne e lexojmë ligjin qartë", - tha Salianji. Por në fakt, ky propozim më shumë dëmtonte kryebashkiakët demokratë, Fiqiri Ismailin në Vorë dhe Xhelal Mziun në Kamëz, kjo për vetë faktin se ata konsiderohen si dy kryebashkiakë të fortë dhe që PS nuk ka arritur t'i mundë në asnjë palë zgjedhjeje. Kujtojmë se kryebashkiaku i Vorës, Fiqiri Ismaili, u bë objekt diskutimesh mes ministres së Infrastrukturës Belinda Balluku dhe deputetit socialist, Sadi Vorpsi gjatë shkëmbimit të disa mesazheve telefonike në Kuvend, ku ata shprehnin shqetësimin se si do ta "hiqin qafe" nga Bashkia e Vorës. Nga ana tjetër, PS duket se i ka vendosur që të mos rikandidojë asnjë nga kryebashkiakët e saj aktualë që kanë 3 mandate, përfshi këtu Sejdinin dhe Dakon. Më parë, drejtues të PS kanë bërë të ditur se Sejдини nuk do të rikandidojë për një mandat tjetër, ndërkohë që me këtë propozim socialistët duket se kanë vendosur që të mos rikandidojnë më as Vangjush Dakon në Durrës. Kjo ju vetëm se ka 3 mandate si kryetar bashkie, por edhe se është përfshirë në përgjimet e prokurorisë për bierjen e votave dhe është vendosur në qendër të akuzave të opozitës. Vetëm dy ditë më parë, kryetari i PD-së, Lulzim Basha paralajmëroi se janë intensifikuar zhvillimet që do të sjellin arrestimin e Vangjush Dakos. Kreu i Komisionit të Ligjeve, Ulsi Manja tha dhe se këtë çështje PS-ja do ta çojë në Kolegjin Zgjedhur, ndërsa u shpreh se të vjetrit duhet të hapin "krahun" për elementë të rinj.

United Nations Development Programme

**TENDER ANNOUNCEMENT**

Subject: ITB for "CONSTRUCTION OF SEWAGE SYSTEM & REHABILITATION OF ROADS IN ROMA QUARTER IN KULLE VILLAGE, DURRES MUNICIPALITY"

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the provision of the above mentioned services/works.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline, set in a sealed envelope and with clearly marked "CONSTRUCTION OF SEWAGE SYSTEM & REHABILITATION OF ROADS IN ROMA QUARTER IN KULLE VILLAGE, DURRES MUNICIPALITY" to the address below.

For more details please refer to the link below:

[http://procurement-notice.undp.org/view\\_notice.cfm?notice\\_id=53571](http://procurement-notice.undp.org/view_notice.cfm?notice_id=53571)

Relevant Dates: All interested companies should provide their offer in the following address, not later than 12 March 2019, at 14:00 hrs

Address for Communication and offers' submission:

United Nations Development Programme Albania  
Str. "Skënderbej", Gurten Center, 2nd floor,  
Tirana, Albania  
Fax.No: + (355) 4 225 02 86  
E-mail: [procurement.al@undp.org](mailto:procurement.al@undp.org)

Kryeregjistruesi Valdrin Pjetri shpjegon procedurat për regjistrimin e ndërtimeve të legalizuara

# Pjetri: 31 mijë ndërtime në pritje përfundojnë brenda korrikut

*Certifikatë pronësisë, qytetarët të informohen pranë hipotekave*

Rreth 31 mijë leje legalizimi që janë në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në të gjithë vendin do të kthehen në certifikata pronësisë brenda korrikut të këtij viti. Këto leje janë administruar nga hipoteka që nga viti 2012 e në vazhdim, por që nuk janë trajtuar asnjëherë nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. "Aksioni" i hipotekës për regjistrin e këtyre pronave është bërë i ditur dje nga kryeregjistruesi Valdrin Pjetri: "Ne kemi një lajm të mirë për qytetarët e Shqipërisë, në tetor të vitit 2018 Zyrat Qendrore dhe Vendore të Pasurive të Paluajtshme bënë një inventar fizik të lejeve të legalizimit të ardhura në zyrat tona, por të patrajtuara kurrë. Këto leje startojnë nga 2012, 2013 e në vazhdim ku ishte krijuar një stok prej 31 mijë leje legalizimi të ardhura në zyrat tona, por të patrajtuara. Bëmë një ndërhyrje të vogël ligjore me mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë, bëmë planin e punës dhe këto leje do të trajtohen brenda korrikut të vitit



Kreu i Hipotekave, Valdrin Pjetri

2019", - tha Pjetri. Sipas tij, krijimi i Agjencisë Kombëtare e Kadastrës do të zgjidhë përfundimisht çështjen e pronave. "Agjencia Kombëtare e Kadastrës është për t'u krijuar dhe për pak ditë kalon ligji në Kuvendin e Shqipërisë, ku qytetari do

të ketë një sportel të vetëm dhe këtu kemi të bëjmë me bashkimin e tri institucioneve kryesore të trajtimit të pronave në Shqipëri, që është Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, zyra e ALUIZNI-t dhe Agjencia e Itinerarit të Pronës Publike.

Pjesë e agjencisë dhe ligjit të ri do të jetë edhe trajtimi i hartave", - deklaroi për "Scan" Valdrin Pjetri.

## AGJENCIA

Pak javë nga krijimi i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, kreu i Hipotekave, Valdrin Pjetri, thotë se grupimi e institucioneve të pronës nën një institucion të vetëm do sigurojë një shërbim më cilësor e më të shpejtë për qytetarët. Pjetri thekson se Agjencia do të përmirësojë bashkëpunimin dhe koordinimin mes institucioneve, duke u dhënë fund problemeve të mospërpjethjes së hartave, të mbivendosjeve apo përplasjeve të titujve, ndërkohë që qytetarët do të marrin çdo shërbim në një sportel. Zyrat e Regjistrimit të Pasurive kanë adresuar edhe problemin e lejeve të legalizimeve që rrinë në pritje prej vitesh, pavarësisht se kanë përfunduar procesin e miratimit tek ALUIZNI. Ligji për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe për përfundimin e proceseve kalimtare të pronës janë në pritje të votohet përsëri në Kuvend, pasi u kthyen për rishqyrtim nga Presidenti i Republikës.

## SHKURTE

Ahmetaj "rrëzon" Peleshin, PPP-të me ofertë të pakërkuar ndalohet përfundimisht

Komisioni i Ekonomisë dhe Financave ka rrëzuar propozimin e Komisionit të Veprimtarive Prodhuese për vendosjen e një moratoriumi deri në dhjetor të vitit 2021 për pranimin e ofertave të pakërkuar në disa sektorë, duke lënë në fuqi variantin e qeverisë, që i ndalon përgjithmonë këto lloj projektsh në rrugë, arsim, telekomunikacion, trajtim mbetjesh e në disa sektorë të tjerë. Ndërkaq, debate pati edhe në lidhje me sektorët ku do të lejohet të pranohet oferta e pakërkuar, ku deputeti Ismet Beqiraj kërkoi që edhe projektet e energjisë për ngrohje dhe shpërndarjen e gazit natyror të përjashtohen nga kjo mundësi. Komisioni i Ekonomisë miratoi nën për nen ndryshimet në ligjin "Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", duke i hapur rrugën miratimit në seancën plenare. Ndërkaq, sikurse është bërë e ditur edhe më herët, ndalimi i ofertës së pakërkuar do të hyjë në fuqi në datën 1 korrik.

Sigurimet, kompanitë paguajnë 3 milionë euro dëme në janar

Kompanitë e sigurimit kanë paguar në muajin e parë të vitit rreth 3 milionë euro për dëmet. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në publikimin e fundit të të dhënave, llogarit se kjo është 14.4% më shumë se në janar të vitit 2018. Vlera e lartë e kompensimeve lidhet përveçse me ato të viteve të fundit, edhe me detyrimet e prapambetura që datojnë më shumë se një dekadë më parë dhe për të cilën ka një program shlyerje. Për vitin 2019, Fondi i Kompensimit i miratuar nga AMF dhe që duhet të paguhet nga kompanitë, është 566 milionë lekë apo rreth 4.5 milionë euro. Nga këto, vlera 218.5 milionë lekë është aktuar për shlyerjen e detyrimeve për pagesat e dëmeve me datë ngjarje sigurimi deri në 31.12.2013 (që u përket praktikave të përfunduara në vlerën 11 milionë lekë si dhe praktikave në proces gjyqësor në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë). Kurse një tjetër vlerë prej 248 milionë lekësh është aktuar për shlyerjen e detyrimeve për pagesat e dëmeve me datë ngjarje sigurimi pas 1 janar 2014 e në vazhdim. "Gjatë janarit 2019, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 92,169 me një rritje prej 4.07% krahasuar me janar 2018. Tregu vazhdoi të mbetej sërish i orientuar te sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.55% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 7.14% dhe veprimtarinë e risigurimit me 0.31%", vlerëson AMF.

## Local publication for call for proposals

### Cross Border Cooperation Programme

Montenegro - Albania

2014-2020

EuropeAid/162-527/ID/ACT/ME



Ministry of Finance of Montenegro, the Directorate for Finance and Contracting of the EU Assistance Funds is seeking proposals for promoting good neighbourly relations, fostering European Union integration and promoting socio-economic development in Montenegro/Albania with financial assistance from the "Cross Border Cooperation Programme Montenegro - Albania for the years 2014-2020", financed by the Instrument for Pre-Accession - IPA II. The full guidelines for applicants are available for consultation at <http://www.cfcu.gov.me/en/tenders> and on the following internet site: <https://webgate.ec.europa.eu/europeaid/online-services/index.cfm?do=publish.welcome>. The deadline for submission of proposals is **27<sup>th</sup> May 2019, before 14:30 hours** local time.

Notice on information session on this Call for Proposals will be published after publishing call for proposals on the website of the Contracting Authority: <http://www.cfcu.gov.me/en/tenders> and on the website of DG International Cooperation and Development <https://webgate.ec.europa.eu/europeaid/online-services/index.cfm?do=publish.welcome>.



## CONTRACT AWARD NOTICE

**Employer:** Albanian Development Fund (ADF)

**Project:** Community Works IV: Development of the Albanian Alps and Coastal Areas

**Contract title:** "Urban Requalification Works in Puka Municipality (second phase)"

**Country:** Albania

**Loan No.:** ALB - LD 1853

**RFB No.:** CW/PIV/W/OP/2018/18

**Issued on:** February 26, 2019

- I. **The duration and summary scope of the contract:** The construction period is 6 months. The works consists in the rehabilitation of road connection to Puke Hospital. The project foresees the construction of drainage and footpaths. The project also takes into account the construction of lighting, greening and vertical and horizontal sign. The project foresees the plastering and painting of the existing old building facades including thermic insulation and in the same time preserving their architectural characteristics. Also new roofs will be constructed in accordance with the old methodology. Also, the project foresees the systematization and Lake protection works. Required works are mainly earth works and landscaping, site systematization, the construction of a lake protection through concrete works and paving works. The Site is located at Puka municipality.
- II. **The selection method used:** The Most Advantageous Bid.
- III. **The Bidder submitting the successful Bid:** "Alba Konstruktion" shpk, Tirana.
- IV. **The Contract price of the successful Bid:** 88,928,369 ALL (net of VAT) - 106,714,042 ALL (VAT included).
- V. **The Bidders who submitted a Bid:**
  - 1) "Alba Konstruktion" shpk.
- VI. **The bid prices as read out at opening of financial parts of bids:**
  - 1) "Alba Konstruktion" shpk. - 88,928,369 ALL (net of VAT) - 106,714,042 ALL (VAT included).
- VII. **The bid prices as evaluated:**
  - 1) "Alba Konstruktion" shpk. - 88,928,369 ALL (net of VAT) - 106,714,042 ALL (VAT included).

Tokat e zëna nga ndërtimet pa leje, lista me përfituesit, paratë kalojnë në llogari

Agjencia e Trajtit të Pronave ka përfunduar procesin e shqyrtimit për 141 kërkesa të paraqitura nga subjektet përfitues, pronarë të pasurive të paluajtshme, pronë private, të prekura nga ndërtimet informale. Pronarët përfitojnë deri më tani kompensimin në vlerë, në masën 70% të shumës së përgjithshme, të miratuar me Vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave. Fondi financiar që shpërndahet nga ATP-ja për këto 141 kërkesa është në vlerën 294 820 890 lekë. Të dhënat në lidhje me pasuritë që kompensohen dhe mbi gjeneralitetet e subjekteve përfitues botohen sot nga "Gazeta Shqiptare". Agjencia e Trajtit të Pronave njofton subjektet e interesuara se vlerat përkatëse

# ATP çel fondin me 295 milionë lekë për 141 pronarë

Rreth 137 milionë lekë, edhe për 12 pronarët që kërkuan pagesa të përshpejtuara

për secilin përfitues do të jenë disponibël në llogaritë e tyre në bankat e nivelit të dytë pas përfundimit të procedurave të transfertave bankare në ditët në vazh-

dim. Kërkesat e përshpejtuara Agjencia e Trajtit të Pronave ka përfunduar shqyrtimin administrativ edhe për 12 aplikimeve për kompensim financiar me

kërkesë të veçantë, për të cilat 'Agjencia' ka miratuar me vendim pranimin e këtyre kërkesave. Fondi financiar i vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, që

ATP do të shpërndajë në total për subjektet përfituese të këtyre 12 aplikimeve sipas kërkesave të tyre është në vlerën 137'963'576 lekë, nga të cilat 28'895'262,10 lekë do të

lëvrohen menjëherë, ndërsa pjesa tjetër do të lëvrohet me këste çdo fillim viti buxhetor; bazuar në mënyrën e përfitimit të kompensimit për të cilën ka aplikuar subjektet.

## LISTA ME 141 PRONARËT NË TË GJITHË VENDIN

BARDHYL			QAZIM			VASIL			QAZIM		
ALI			ZYBER			TODI			XHEMAL		
KIKA			BELBA			THANASI			XHEPA		
NAILE			ETLEVA			ZANMIR			AHMET		
SELIM			ÇESK			VAIT			SULEJMAN		
KADIA			LALA			HASA			KOKONOZI		
TAULANT			AVIDANE			BARDHUL			BRIKENA		
BARDHUL			MYZAFER			FATMIR			THEMISTOKLI		
HAKANI			HOXHA			HAXHIHYSENI			ZOTO		
LIVANTINA			KUJTIM			SOTIRAQ			JUDIT		
BARDHUL			DERVISH			ANASTAS			MUHARREM		
HAKANI			BARAKAJ			GAJDA			SHAHU		
VJOLLCA			ALKION			SANJUE			BAHIR		
QEMAL			SULEJMAN			SHPETIM			MUHARREM		
ARAPI			DIZDARI			FATKOJA			RESULI		
ZENEPE						BUKURJUE			ANILA		
ISMAIL						MYSLIM			KADRI		
TABAKU						SARAÇI			DEMIRI		
LIRI			DASHAMIR			GEZIM			LIRIJE		
ISMAIL			REXHEP			HASAN			MEHMET		
ALLKIA			LORETA			KOKONOZI			DIMRAJ		
			NURI			SHEFOET			ARTUR		
FATBARDHA			BELBA			MYSLIM			TASIM		
RRAPUSH			MUÇA			SHEFOET			KOSOVA		
PRELASHI			DORIAN			AIDA			BUJAR		
KODRASI			HYSNI			SABRI			LATIF		
ALEMSHA			MUÇA			LEKBELLO			XHAMETA		
MYRTEZA						ERJON			VASIL		
KODRASI						HAMDË			NESTURI		
XHYRA			ERLUNDA			BILALI					
XHYRA			HYSNI								
KUTROLLI			ÇAUSHI								
ENVER			ERVEHE								
KASEM			FIQRET								
TABAKU			KAPIDANI								
SEZAI			ARDIAN								
BAXHAKU			MERGIRI								
DARDHA			BEHEKHET								
DARDHA			NAMIK								
HUSHI			HYDI								
HUSHI			VJOLLCA								
HUSHI			ALI			OSMANAGIQ					
SKIFTERI			VERA			KOÇI					
SKIFTERI			ENVER								
SKIFTERI			DURIM			MATISHI					
SKIFTERI			KUJTIM			BELEGU					
ZHUPA			SOKOL			ISMET					
ZHUPA			INGRIT			BAJRAM			DEMNERI		
TUGU			MEHMET			ZYBER			BELBA		
TUGU			BESIM			XHEMAL			SAUKU		
MAÇI			ARBI			DASHAMIR			AGALLIU		
MAÇI			ERVIN			NJAZI			ÇIMA		
MAÇI			SOKOL			IVZI			HAXHIU		
MAÇI			ARIANA			ENVER			STRATI		
MAÇI			LILIANA			IBRAHIM			HUTA		
MAÇI			SUELA			BAJRAM			DEMNERI - HAATAJA		
MAÇI			FJORALBA			ENGJELL			SORRA		
MAÇI			FATMIR			BESIM			MURTHI		
MAÇI			KOÇO			PETRO			POPE		
MAÇI			BARDHYL			NAIM			SHASHAJ		
MAÇI			ZEMAIDA			SYRRI			MOZALI		

## LISTA E SUBJEKTEVE QË PËRFITTOJNË KOMPENSIM FINANCIAR ME KËRKESE TË VEÇANTË

VENDIMI I KKKP				SUBJEKTI I SHPRONËSUAR		PËRFAQËSUESI ME PROKURË		APLIKIMI NË ATP			
NR.	DATE	MUJ	VITI	BASHKIA	EMËR	MBIEMËR	EMËR	MBIEMËR	NR. DOSJE	DT. E HAPJESË SË DOSJES	KËRKESE E SUBJEKTI PËR KOMPENSIM TË VEÇANTË
956	20	3	1996	SHKODER	DAUT	BEÇI	ASTRIT	BEÇI	39	29.01.2019	20%
1105	21	9	1996	TIRANE	HANE DHE ISLAM	KUKA	VASJANA	TONA	1306	14.12.2018	30%
883	23	11	1994	TIRANE	BEDRI	LLAGAMI	MIRANDA	NOSI	18	17.01.2017	40%
19	24	3	1995	FIER	KOSTANDIN	DHIMA	XHILDA	NUSHI	983	27.07.2018	40%
294	9	8	1995	TIRANE	KADRI	ASLLANI	FATMIR	ASLLANI	940	26.07.2017	40%
88	4	10	1995	VLORE	SAVA (ELISAVETA)	ANDRIKO	JORGO	TALO	1305	14.12.2018	40%
360	1	12	1995	KAVAJE	HASAN	BABRAMA	SHAQIR	BABRAMA	514	24.05.2017	40%
515	11	2	1996	TIRANE	MAHMUDE	VELJA	ESMA	ÇALI	45	30.01.2019	40%
458	26	2	1996	TIRANE	SOTIR	CEKANI	VALENTINA	ALANAJ	1084	19.09.2018	40%
623	11	7	1996	TIRANE	HYSEN	QATPI	DITIKA	QATPI	1209	08.11.2018	40%
168	12	4	1995	LUSHNJE	PETREF	MEBELLI	FERIT	MEBELLI	21	18.01.2019	40%
9	9	2	1999	LUSHNJE							40%
390	28	7	2006	TIRANE	NIGJAR	FEVZI	HEKTOR	BREGASI	1310	18.12.2018	40%

SHKODËR

Avokati i Hoxhës: Vendimi i gabuar, klienti im u dënua pa asnjë provë shkencore

Gjykata e Shkallës së Parë në Shkodër ka dënua dje me 12 vite burg Elvis Hoxhën dhe me 8 vite Ditmir Arifin për vrasjen e Hermes Beqirit, ngjarje kjo e ndodhur në nëntor të vitit 2017 në lagjen "Guerrile" të këtij qyteti. Ndërkaq, Kreshnik Kolndreaj, avokati i Elvis Hoxhës e konsideroi të padrejtë vendimin e dhënë nga togat e zeza. Në një deklaratë për media, Kolndreaj i doli në mbrojtje klientit të tij, ndërsa u shpreh se ai është dënua pa asnjë provë shkencore. "Për sa i përket vendimit të sotshëm, Gjykata e Shkallës së Parë ka gabuar. Është i vetmi person që është dënua pa asnjë provë shkencore. Jemi në kushtet që minimumi të jetë një provë shkencore. Nuk ka asnjë gjykatë, jo vetëm në Shqipëri, por as në vendet e treta që dënon një person pa asnjë provë", tha avokati Kolndreaj.

VRASJA

Ngjarja ndodhi më 4 nëntor të vitit 2017, rreth orës 19:20, kur shtetasi Hermes Beqiri mbeti i plagosur rëndë në lagjen "Guerrile", në vendin e quajtur ish-Zooteknika, e më pas ndërruajet. Në momentin e plagosjes, Hermes Beqiri ishte duke qëndruar në një lokal kur u qëllua me armë zjarri. Policia që në fillim pati dyshime se autori është Elvis Hoxha. Sipas burimeve policore, dy të rinjtë njiheshin më përpara dhe kanë pasur një grindje të çastit për motive banale (për një kapele), gjë e cila sollti edhe plagosjen e 20-vjeçarit Hoxha, pasi ka debatuar me Beqirin, ka marrë një pistoletë dhe e ka qëlluar disa herë. Hermes Beqiri (i dënua më parë për vjedhje) u qëllua për vdekje me 6 plumba në bark dhe kraharor. Ka qenë dëshmia e bashkëpunëtorit, Ditmir Arifi që ka hedhur dritë mbi ngjarjen.

DËSHMIA E DITMIR ARIFIT

Ndryshe nga Elvis Hoxha, shtetasi tjetër i akuzuar Ditmir Arifi ka treguar me detaje vrasjen e ndodhur. Sipas tij është Elvis Hoxha ai që ka qël-

# Vranë të riun pas sherrit për një kapele, dënohen me 20 vite heqje lirie 2 autorët

## Gjykata jep 12 vite burg për Elvis Hoxhën dhe 8 vite burg për bashkëpunëtorin Ditmir Arifi



Viktima Hermes Beqiri

luar Hermes Beqirin. Sipas avokatit mbrojtës të Ditmir Arifit, klienti i tij, Elvis Hoxha dhe viktima janë takuar së bashku me 4 nëntor 2017. Ditmir Arifi tha se ka bërë një xhiro me motorin e viktimës duke qenë se njiheshin dhe më pas Ditmiri ka bërë një xhiro i vetëm me motorin e viktimës. Në atë moment Elvis Hoxha dhe Hermes Beqiri janë konfliktuar. Viktima i ka marrë kapelen Elvis Hoxhës dhe i ka thënë se s'dua ta jap më. Më pas ia ka dhënë, por e ka sharë Elvisin dhe e ka goditur, kjo sipas deklarimeve të palës

mbrojtëse të Ditmir Arifit. Më pas Elvis Hoxha ka marrë në motorin e tij Ditmir Arifin dhe janë larguar nga aty. Pasi janë larguar autori i dyshuar ka marrë në një kanal në lagjen Kiran në automatik kallashnikov, por Ditmir Arifi nuk ka patur dijeni se shoku i tij ishte armatosur, këtë e ka thënë edhe vetë Hoxha në hetimet paraprake. Janë rikthyer në vendin ku ndodhë Hermes Beqiri pas rreth 15 minutash dhe sipas Arifit Elvis Hoxha e ka qëlluar viktimën pa u ulur nga motori duke e lënë të plagosur rëndë. Janë larguar

DËSHMIA E ELVIS HOXHËS

Prokuroria e Shkodrës ka kërkuar 12 vite burg për Elvis Hoxhën, i akuzuar si autor i vrasjes të Hermes Beqirit dhe 8 vite për Ditmir Arifin i akuzuar si bashkëpunëtor në këtë vrasje. I pandehuri Hoxha dhe avokati mbrojtës i tij nuk e kanë pranuar autorësinë për vrasjen e Hermes Beqirit. I pandehuri deklaroi përpara gjykatës se në momentin e vrasjes ai nuk ka qenë fare në vendin e ngjarjes. Elvis Hoxha u shpreh se vrasja e Hermes Beqirit është kryer nga një person i tretë, i cili e ka kërcënuar me jetë Elvisin dhe familjen e tij nëse do të flasë përpara drejtësisë.

përsëri me motorin e Elvisit dhe në lagjen Rus autori i dyshuar i ka kërkuar Ditmirin që të ulet nga motori tij. Ditmir Arifi ka shkuar në shtëpi ndërsa Elvisi drejt njësisë Rrethina ku edhe është arrestuar pak orë pas ngjarjes. Kështu pala mbrojtëse e Ditmir Arifit dhe vetë i dyshuari deklaruan se s'kishte asnjë qëllim nga ana e Ditmirit për të vrarë Hermes Beqirin duke qenë se ata ishin shokë që më përpara dhe se Ditmiri nuk e ka ditur se Elvis Hoxha ka marrë armë. Pala mbrojtëse kërkoi që vepra penale të ndryshohet nga "vrasje me paramendim" në "vrasje me dashje" sepse e gjithë ngjarja ka ndodhur për rreth 15 minuta dhe në gjaknxehtësi e sipër. Pala

mbrojtëse kërkoi dënim alternativ me shërbim prove për Ditmir Arifin duke patur parasysh rrethanat lehtësuese si tregimi i ngjarjes me detaje, pendimi për shqërimin e autorit me motor dhe faktin se ka qenë i mitur, por edhe se ka patur gjithnjë një sjellje të mirë. Prokurori i çështjes Albert Murcaj vazhdoi t'i qëndrojë kërkesës së tij për 12 vite burg për Elvis Hoxhën dhe 8 vite burg për Ditmir Arifin duke thënë se pretendimet e avokatëve janë të papabuzuara. Në fund trapa gjykuese e drejtuar nga Arbër Çela shtyu seancën me 26 shkurt u tashmë ka mbetur vetëm për t'u dhënë dënimi përfundimtar nga gjykata e shkallës së parë.

SHKURT

Incidenti me ashensorin,

arrestohet tekniku

TIRANË - Policia ka vënë në pranga teknikon e pallatit në "Don Bosko" pas incidentit të së hënës, ku një vajzë pësoi lëndime si pasojë e shpëputjes së ashensorit. Tekniku i arrestuar kishte kontrolluar para dy muajsh sigurinë e ashensorit në pallat, ndërsa ishte shprehur se nuk ka asnjë problem teknik. Gjithashtu, 49-vjeçari A.M. nuk kishte lëshuar certifikatë sigurie, gjë e cila e ngarkon me përgjegjësi shtesë për këtë situatë. Materialet në ngarkim të tij u referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprimet të mëtejshme në ngarkim të shtetasit të lartpërmendur për veprën penale "Shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë".

Goditën punonjës

e portit, dy

persona në pranga

DURRËS - Dy persona janë prangosur nga policia e Durrësit, pasi kanë qëlluar me tytë pistoletë në kokë një punonjës të portit të këtij qyteti. Arrestimi i tyre u bë, pasi rreth orës 17:00, në hyrje të portit, në bashkëpunim me një person tjetër ende të pa identifikuar, dyshohet se kanë goditur me sende të forta në kokë punonjës në shërbim të Autoritetit Portual, i cili po merr ndihmë në spital. Të arrestuarit janë shtetasit R.D., 38 vjeç, dhe H.B., 40 vjeç, ndërsa policia po punon për identifikimin dhe kapjen e autorit të tretë të kësaj ngjarje. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, për veprat penale "Plagosja e rëndë me dashje", "Mbasjtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyeshe dhe municionit", "Goditja për shkak të detyrës", kryer në bashkëpunim.

## Ekzekutoi kumatën dhe e hodhi në ferra, kapet në Peshkopi 39-vjeçari Dashamir Xhepa



Viktima Lirie Xhepa

I arrestuari Dashamir Xhepa

dysuar të vrasjes së shtetasës L.Xh., janë vënë në ndjekje intensive të tij. Në sajë të informacioneve të marra në rrugë operative shërbimet e policisë lokalizuan vendndodhjen e autorit të dyshuar, shtetasit D. Xh. dhe bënë kapjen dhe arrestimin e tij në qytetin e Peshkopisë ku dhe strehohej. Gjithashtu, u arres-

tua dhe shtetasi M.S., për "Përkrahje të autorit të krimit", i cili ka ndihmuar dhe strehuar autorin e dyshuar. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprat penale "Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare", "Armëmbajtje pa leje", në ngarkim të shtetasit D. Xh., dhe për veprën penale "Përkrahje e autorit të krimit", në ngarkim të shtetasit M. S.", njofton policia. Nëna e katër fëmijëve u ekzekutua me tre plumba më 13 shkurt. Mësohet se konflikti mes Lirie Xhepës dhe kumatit të saj, Dashamirrit ka nisur që në 2008 për pronat. Madje në 2008 ajo ka shkuar në spital me shenja dhune në kokë, por ka deklaruar se ka renë nga shkallët.



## Vrau fqinjin pas sherrit në lokal, dorëzohet 38-vjeçari

DURRËS - Dy ditë pas vrasjes së 45-vjeçarit Martin

Ndreca, është vetëdorëzuar në policinë e Shkodrës autori i krimit, Ndue Zefi. Mësohet se grupi i gatshëm i policisë së Durrësit po bën transferimin e 38-vjeçarit për në Komisarjatin e këtij qyteti. Pas vrasjes së fqinjit të tij në zonën e Ish-Kënetës, Zefi ka shkuar në Pukë, në vendlindjen e tij. Zefi dhe Ndreca kishin qenë duke pirë raki në një lokal të zonës, kur një debat për politikën përfundoi në fyerje e përplasje fizike mes tyre. Dëshmitarë treguan në polici se sherrri ishte shuar pas ndërhyrjes nga të pranishmit në lokal dhe pas kësaj, 45-vjeçari Ndreca kishte hipur në makinë për t'u larguar. Por Zefi nuk e la me kaq. Ai shkoi në shtëpi, mori automatikun dhe e ekzekutoi mikun e tij duke e lënë të vdekur në vend.

DIBËR - Dy javë pas vrasjes së 49-vjeçares Lirie Xhepa, trupit pajetë i së cilës u gjet i masakruar mes ferrash në afërsi të Liqenit të Sharrës në Tiranë, policia ka vënë në pranga autorin e dyshuar të krimit. Bëhet fjalë për kumatin e viktimës, Dashamir Xhepa, i cili u arrestua në Peshkopi, ndërsa po tentonte të largohej jashtë vendit. 39-vjeçari Xhepa u shpall në kërkim me datë 14 shkurt, ndërsa ditën e djeshme u gjet i fshehur në hotelin e shtetasit Mensut Sula. "Shërbimet e policisë Tiranë, pas identifikimit të autorit të

**SHPLLJE ANKANDI**

Zyra Përmbartore "E.G Bailiff Service" me përmbartues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 20.03.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i II-të për shfitjen e pasurisë së paluajtshme, Apartamenti me sipërfaqe totale 86.35 m<sup>2</sup>, me numër pasurie 2/139ND+13, volumni 71, faqe 142, zona kadastrale 9518, me adresë Lagja 13, Plesh, Hyrja 1, Ap.13 Durrës, në pronësi të Z.Cilim Sejfulla Xhafa dhe Znj.Bardha Xhemal Xhafa me vlerë fillestare në ankad 22.727.6 (Njëzet e dy mijë e shtatëqind e njëzet e shtatë pikë gjashtë) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 06720027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com



**VLORË** - Pesë makina janë djegur në orët e para të mëngjesit të djeshëm në Vlorë. Mësohet se automjetet ndodheshin të parkuara pranë njëra-tjetrës, në zonën e Ujit të Ftohtë, ndërsa paraprakisht dyshohet për zjarvrënie të qëllimshme. Kjo për faktin se në vendngjarje janë gjetur edhe bidonë me benzinë. Dyshohet se objektivi i ngjarjes të ketë qenë makina e drejtorit të Shërbimeve Publike në bashkinë e qytetit bregdetar, Gentjan Sherifaj.

**Gentjan Sherifaj, nën hetim për koncesionin e parkingjeve**

**Shkrumbohen 5 makina, mes tyre edhe e drejtorit të Shërbimeve Publike në Bashkinë e Vlorës**

faj dhe bashkëshortes së tij, ndërsa djegia e tri automjeteve të tjera ka qenë aksidentale si pasojë e përhapjes së flakëve. Pas sinjalizimit për djegien e mjeteve, policia dhe zjarrfikësit kanë shkuar shpejt në vendngjarje dhe kanë ndërhyrë për shuarjen e flakëve. Blutë kanë

marrë në pyetje zyrtarin e bashkisë, ndërsa kanë sekuestruar kamerat e sigurisë që ndodhen në afërsi të bllokut të pallateve ku u dogjën makinat. Gentjan Sherifaj është në hetim bashkë me ish-kryebashkiakun e Vlorës, Shpëtim Gjika dhe 6 ish-zyrtarë të tjerë të bash-

kisë. Ata akuzohen për shpërdorim të detyrës, pasi si anëtarë të komisionit që ishte ngarkuar për krijimin e kushteve të dhënies të koncesionit të parkingjeve në 24 rrugë të Vlorës, kanë shpallur fituese një kompani 'off-shore' me kontratë 15-vjeçare.



"Metropolis", në total 33 persona të arrestuar, 6 të tjerë ende në kërkim

**TIRANË**

**N**jë tjetër operacion i përbashkët ndërko mbëtar në fushën e trafikimit të drogës është finalizuar me arrestimin e pesë shtetasve shqiptarë, të cilët ishin shpallur në kërkim nga autoritetet italiane. Gjatë një konference për shtyp, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu, bëri me dije se personat e vënë në pranga ishin pjesë e një bande që trafikonte droga të forta dhe se do të ekstradohen drejt vendit fqinj. Gjatë fjalës së tij, Veliu tha se ata u kapën në kuadër të hetimeve të karabinierëve të Breshias për aktivitetin kriminal të trafikimit të lëndëve narkotike. "Policia e Shtetit përditë e më shumë po rrit bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë në luftën kundër krimit të organizuar, bashkëpunim i ndërthurur mbi baza besueshmërie reciproke, duke zhvilluar dhjetëra operacione ndërkombëtare. Në këtë kuadër, gjatë 12 orëve të fundit është finalizuar një tjetër operacion i përbashkët me interforçën italiane, i koduar 'METROPOLIS', në fushën e trafikut të drogave të forta. Në përfundim të operacionit të përbashkët 'METROPOLIS' me autoritetet policore italiane, u arrestuan gjithsej 33 persona, nga këta 5 persona në Shqipëri, ndërsa 6 persona të cilët nuk janë kapur ende janë shpallur në kërkim ndërkombëtar dhe po vijon puna për kapjen e tyre", deklaroi ndër të tjera kreu i Policisë së Shtetit.

**Megaoperacioni antidrogë në bashkëpunim me Italianë, përfundojnë në pranga 5 shqiptarë**

*Të arrestuarit në Tiranë, Durrës dhe Shkodër do të ekstradohen në vendin fqinj*



- PERSONAT E ARRESTUAR NË SHQIPËRI**
- 1. **G.S., 24 vjeç**, lindur dhe banues në Tiranë.
  - 2. **S. D., 43 vjeç**, lindur në Gërmenj dhe banues në Tiranë.
  - 3. **E.H., 39 vjeç**, lindur dhe banues në Shijak/Durrës.
  - 4. **A. M., 32 vjeç**, lindur dhe banues në Shijak/Durrës.
  - 5. **L. P. 35 vjeç**, lindur dhe banues në Shkodër.

ues në Tiranë, E.H., 39 vjeç, lindur dhe banues në Shijak/Durrës, A.M., 32 vjeç, lindur dhe banues në Shijak/Durrës, L.P. 35 vjeç, lindur dhe banues në Shkodër. Njësia Operative Radiomobile e karabinierëve të Breshias/Itali, në muajin mars të vitit 2015, ka nisur hetimin në lidhje me aktivitetin kriminal në drejtim të importimit në sasi të mëdha të lëndëve narkotike të llojit kokainë, nga Holanda në drejtim të Italisë. Në përfundim të hetimeve, gjykatësi për Hetimet Paraprake i Gjykatës së Breshias/Itali ka dhënë masat e arrestit ndaj 39 subjekteve. Në këto masa përfshiheshin dhe shtetasit shqiptarë që ndodheshin në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilët u arrestuan me qëllim

ekstradimi për në Itali. Në përfundim të operacionit të përbashkët "METROPOLIS" me autoritetet policore italiane, u arrestuan gjithsej 33 persona, nga këta 5 persona në Shqipëri, ndërsa 6 persona të cilët nuk janë kapur ende, janë shpallur në kërkim ndërkombëtar dhe po vijon puna për kapjen e tyre. Policia e Shtetit është e angazhuar për të rritur forçën goditëse në territor ndaj çdo paligjshmërie, si dhe në bashkëpunim të ngushtë me agjencitë e tjera ligjzbatuese dhe me partnerët ndërkombëtarë në luftën kundër krimit të organizuar, krimet ekonomik dhe financiar, korrupsionit, trafikëve të paligjshme dhe akteve terroriste që cenojnë sigurinë e jetës së qytetarëve apo sigurinë kombëtare.

**HETIMET**  
Njësia Operative Radiomobile e karabinierëve të Breshias/Itali, në muajin mars të vitit 2015, ka nisur hetimin në lidhje me aktivitetin kriminal në drejtim të importimit në sasi të mëdha të lëndëve narkotike të llojit kokainë, nga Holanda në drejtim të Italisë. Në përfundim të hetimeve, gjykatësi për Hetimet Paraprake i Gjykatës së Breshias/Itali ka dhënë masat e arrestit ndaj 39 personave.

**Lleshaj: Goditje e rëndësishme të të dyja palëve ndaj krimit të organizuar**  
**TIRANË** - Pas njoftimit zyrtar të Policisë së Shtetit për finalizimin e operacionit të përbashkët me policinë italiane, gjatë të cilit ranë në pranga pesë persona me qëllim ekstradimitin drejt Italisë, ka reaguuar edhe ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj. Ai e quajti aksionin një goditje të rëndësishme të të dyja palëve ndaj krimit të organizuar. "Tjetër goditje e rëndësishme e Policisë së Shtetit dhe partnerëve italianë kundër krimit të organizuar. Kjo është një tjetër dëshmi se motivimi i PSH është i lartë dhe se besimi i partnerëve është maksimal. Mirënjohje dhe mbështetje për policinë tonë dhe partnerët tanë", shkruan Lleshaj.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**  
**DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT**  
**SEKTORI I PROKURIMIT**

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi 3-vjeçar i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemeve të mbrojtjes elektronike në objektet dhe degët e Bankës së Shqipërisë".  
"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 27,000,000 Lekë**". Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halli", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi 3-vjeçar i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemeve të mbrojtjes elektronike në objektet dhe degët e Bankës së Shqipërisë".  
Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **25 Mars 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.







# VIP

Suplement  
Pages

E mërkurë 27 Shkurt 2019 GAZETA SHQIPTARË Redaktore: Pamela Aliaj

## "BULEVARDI POLITIK"

- Rama tradhton Juventusin me Liverpoolin dhe pa dashje shkel ligjin e ndalimit të basteve
- Erion Braçe nuk është ambientuar ende me postin e ri të zëvendëskryeministrit
- E stresuar nga Brexit, Theresa May luan bilardo me homologun europian
- Ish-anëtarja e stafit padit Trump: Më puthi pa dëshirë

"Pse s'lidhesh me Islin"? Ori Nebijaj i jep përgjigjen e papritur fanses



"Tavolina e mërzisë", Elvana Gjata publikon këngën e shumëpritur



Nga Era Istrefi, te Shyhrete Behluli, ja njerëzit e famshëm që kanë pasaportën tonë



## VIP-at kosovarë që kanë marrë shtetësi shqiptare

*Me dy pasaporta, edhe pse me të njëjtën prejardhje, artistët e Kosovës njihen si shqiptarë në botë*

Nga Era Istrefi, te Shyhrete Behluli, ja njerëzit e famshëm që kanë pasaportën tonë

# VIP-at kosovarë që kanë marrë shtetësi shqiptare

Me dy pasaporta, edhe pse me të njëjtën prejardhje, artistët e Kosovës njihen si shqiptarë në botë

Pamela Aliaj

Shumë nga VIP-at kosovarë për një arsye apo për një tjetër e kanë kërkuar shpesh pasaportën shqiptare. Dhe ndër vite jo pak prej tyre iu është dhënë, duke i ndihmuar kështu të performojnë e të marrin pjesë në evente tepër të rëndësishme botërore, duke na bërë kështu tepër krenarë. Por dihet se arsyeja kryesore është mosliberalizimi i vizave të Kosovës gjë që u hap atyre shumë rrugë duke patur pasaportën shqiptare. Shumë raste vijnë të mbledhura në "VIP Pages" të "Gazeta Shqiptare", ndërkohë që ne do t'ju listojmë më të fundit që kanë arritur të përveçtojnë nga presidentët tanë shtetësinë shqiptare:

## GOLD AG

Reperi është bërë shtetas i Shqipërisë. Gold AG është artisti i radhës, i cili është bërë me pasaportë të Shqipërisë. Arian Agushi ka hedhur një imazh në llogarinë e tij personale, "Instagram" dhe tregon se është bërë shtetas i Shqipërisë. "Prej sot shtetas Shqipërie", ka shkruar ai.


## ERA ISTREFI

Era Istrefi tanimë është 100 për qind shqiptare. Këngëtarja është lindur në Kosovë, por është e njohur ndërkombëtarisht për muzikën e saj. Para dy vitesh ajo ka marrë edhe nënshtetësinë shqiptare me një dekret të zyrtares nga Presidenti i Republikës, Bujar Nishani. Në një rrëfim ekskluziv në "Top Albania Radio", Era Istrefi shprehu emocionin për marrjen e pasaportës dhe nuk kurseu falënderimet për ata që e mundësuan këtë. "Falënderimet e mia për Presidentin e Republikës së Shqipërisë, ministrinë e Kulturës së Kosovës dhe Shqipërisë janë të panumërta, sinqerisht. Disa gjëra nuk do të kishin ndodhur po të mos ishte kjo pasaportë. Falënderimet e mia janë të panumërta dhe shpresoj se do ta përfaqësoj denjësisht vendlindjen time të dytë anembanë botës", shprehet Era.

## SHPAT DEDA

Këngëtarja i njohur Shpat Deda është shumë i pëlqyer nga publiku shqiptar për këngët e tij. Ai gjithmonë ka kultivuar muzikën e lehtë dhe me vlera, ndërsa është mjaft aktiv me projekte të reja në muzikë. Përveç muzikës, ai është edhe producent, ndërsa ka arritur të fitojë çmimin kryesor në BAF-TA. Së fundmi, këngëtarja Deda ka shijuar disa ditë të mira pushimi, ndërsa disa prej këtyre momenteve i ka ndarë me ndjekësit e tij në rrjetet sociale. Ndryshe nga shqiptarët e Kosovës, Shpat duket se nuk ka problem me vizat dhe ndjehet i lumtur që posedon një pasaportë të tillë.

## NORA ISTREFI



Sabri Fejzullaj



Fifi

Presidenti i Republikës, Ilir Meta i ka dhënë pasaportën shqiptare këngëtares nga Kosova, Nora Istrefi përmes një dekreti që mban numrin 10822 dhe datën 12.7.2018. Po ashtu, me pasaportë janë pajisur edhe vëllai i saj Bledi dhe nëna, Syzana. Ndërsa, këngëtarja tjetër e familjes Istrefi, Era ka marrë pasaportën shqiptarë disa muaj më parë se ta merrte Nora, gjë që i mundësoi asaj të performonte në finalen e Kupës së Botës, pasi Rusia nuk e

një shtetin e Kosovës. **SHYHRETE BEHLULI DHE MIHRRIJE BRAHA**

Këngëtarët e njohura kosovare bëhen me pasaportë shqiptare. Presidenti i Republikës, Ilir Meta, u ka dhënë shtetësinë shqiptare dy këngëtareve të njohura nga Kosova, Mhirrije Braha dhe Shyhrete Behluli, të cilat janë një ndër më të dashurat për publikun tonë.

Pavarësisht problemeve të shumta, mes shqiptareve të Kos-




Nora Istrefi



Flaka Krelani



Gold Ag




Shpat Deda



Shyhrete Behluli

Mhirrije Braha



Era Istrefi

ovës dhe atyre të Shqipërisë ekziston një lidhje e veçantë. Ata asnjëherë nuk kanë bërë diferencim në prejardhjen e tyre dhe në çdo vend të botës që shkojnë, krenohen hapur duke thënë se janë shqiptarë. Këtë lidhje të veçantë e dëshmojnë edhe VIP-at nga Kosova, të cilët kanë shprehur dëshirën e tyre të madhe për të pasur një pasaportë shqiptare. Pavarësisht ndarjes territoriale, duket se asgjë nuk mund ta mposhtë ndjenjën e bukur kur je i lidhur në gjak. Përveç kësaj, edhe një arsye tjetër qëndron pas kësaj kërkesë. Të pasurit një pasaportë shqiptare u mundëson VIP-ave një lirishtetëri për të udhëtuar në vendet e Europës e veçanërisht për të ushtruar profesionin e tyre aty ku më së shumti jetojnë shqiptarët emigrantë. Thellë-thellë, me siguri kjo është edhe më e rëndësishmja. Një tjetër gjë që tërheq vëmendjen është se kërkesa faktikisht u drejtohet personave të gabuar të shtetit. Fillimisht duhet të dish kujt t'ia kërkesë, e më pas bëhet thirrja. Por ka edhe nga ata VIP-a kosovarë, të cilët ende nuk e kanë marrë dhe e kërkojnë një pasaportë shqiptare. "VIP Pages" po ju liston disa prej tyre, të cilët i kanë bërë thirrje publikisht presidentit të vendit për të pasur pasaportë shqiptare:

## SABRI FEJZULLAHUT

Sabri Fejzullahu ka treguar çfarë i ka mbetur peng në zemër. Ndërsa ishte i ftuar në emisionin "Lart e Poshtë", këngëtarja tha se ia ka dashur zemra gjithmonë që ta ketë një pasaportë shqiptare, edhe pse vizat nuk i janë refuzuar asnjëherë nga ambasadat. "Peng në zemër e kam, pse nëna Shqipëri nuk ma

dhuroi një pasaportë shqiptare. E di pse? Ma do zemra ta kem një pasaportë si shqiptar. Unë i marr vizat gjithandej dhe këtu i falënderoj të gjitha ambasadat që janë në Kosovë, kurrë në jetë nuk na refuzuan vizën as mua, as familjarëve të mi. Unë kam dëshirë, kam dashur, e dua dhe e kam peng që ta kem një pasaportë shqiptare", ka treguar këngëtarja.

## FILLORETA RAÇI

"Aman, atë pasaportë. Zoti kryeministër, atë pasaportë! Po ta bëj kërkesën mediatisht 'live', si i bëhet për ta marrë?! OK, e di që është presidenti që ta jep, por Rama mund të më ndihmojë", tha Fifi gjatë një emisioni 'live'.

## LABINOT TAHIRI

Këngëtarja Labinot Tahiri bëri një kërkesë drejtuar përfaqësuesve politikë të Shqipërisë, duke iu lutur që t'i bëjnë pasaportën shqiptare, pasi ai është shqiptar dhe nuk dëshiron që nëna e tij të vdesë pa e parë që djali i tij ka emrin në një dokument kaq të rëndësishëm shqiptar. Për më tepër, i drejtohej të gjithë krerëve të shtetit, ndërkohë që kërkesa i duhej dërguar vetëm presidentit.

## FLAKA KRELANI

Këngëtarja e njohur e kërkoi 'live' në emisionin "Rudina", pasaportën shqiptare dhe të paktën ajo e pranoi që i nevojitej për realizimin e koncerteve.

## ANA KABASHI

Gjithashtu, edhe kjo këngëtare në emisionin "Top Show"// u ka kërkuar krerëve të shtetit nënshtetësinë shqiptare për të pasur mundësinë që të lëvizë lirshëm për koncerte.

**P**ara 2 vitesh, në 2 maj 2017, erdhi në jetë vogëlushi i këngëtares Tuna dhe Patrisit. Edhe pse fillimisht ishte e vështirë për të përcaktuar nëse Tian i ngjan më shumë mamit apo babit, me kalimin e kohës i vogli po shfaq çdo herë e më shumë tipare të



Patrisit (që me siguri do të jetë shumë krenar). Si për t'i vënë 'vulën' këtij konstatimi, muzikanti ka postuar një foto të fëmijërisë së tij rrjetin social "Instagram", e nëse s'do ishin flokët e dendura kaçurtele, do të betoheshim se ky vogelush është Tian. Të njëjtat tipare e i njëjti vështrim, me këtë foto Patris Berisha duket se e fitoi 'luftën' me bashkëshorten e tij, Tunën, pasi me siguri si në çdo familje, edhe në tyren ekziston ajo 'lufta e ftohtë' për të marrë meritat e ngjashmërisë së fëmijës. Epo na vjen keq Tuna, pasi Tian për momentin është "bëmë baba të të ngjaj"!



## Si dy pika uji! Vogëlushi i Tunës qenka kopje e Patrisit të vogël!

**T**e dy ata janë çifti më simpatik i prezantuesve që na bëjnë zgjimin çdo mëngjes në "Wake Up", në "Top Channel". Pavarësisht angazhimit të tyre të përditshëm e profesional, Ori Nebijaj dhe Isli Islami na kanë treguar herë pas here se janë edhe miq shumë të mirë me njëri-tjetrin. Por mesa duket, ka njerëz të tjerë që mendojnë se mes tyre ka më shumë se sa një raport profesional dhe mes miqsh. Kështu, ka qenë një foto që vetë Ori Nebijaj ka postuar në "Instagram"-in e saj, ku shfaqet bashkë me Isli



Islamin, kolegun e "Wake Up". Fotoja është pëlqyer shumë dhe komentet nuk kanë munguar! Por, në mesin e tyre ka pasur një koment që duket se e ka acaruar jo pak, prezantuesen simpatike Ori Nebijaj. "Sa shkoni si çift, pse nuk lidheni ju të dy? Apo jeni edhe nuk tregoni?", i ka shkruar vajza poshtë fotos së të dyve. Reagimi i Orit ka qenë i drejtpërdrejtë dhe pa rezerva. "Nuk e kuptoj këtë pyetje? Ty të pyesin për miqtë e tu pse nuk lidhesh me ta meqë shkoni?", i ka thënë ajo. Vertet një përgjigje epike dhe direkte, që me siguri e ka lënë pa tekst vajzën që hamendësoi se mes tyre mund të kishte më tepër se sa miqësi të vërtetë!



## "Pse s'lidhesh me Islin"? Ori Nebijaj i jep përgjigjen e papritur fanses

**N**jë nga fitueset e Çmimit Oskar ishte edhe këngëtarja dhe aktorja Lady Gaga, e cila ra në sy me diamantin gjigant që mbante në qafë dhe jo vetëm. Aksesori ishte një varëse me diamant nga "Tiffany", që kushton plot 30 milionë dollarë dhe i bëri kokat të ktheheshin! Megjithatë, nuk pati të njëjtin efekt dhe veshja e këngëtares, që dukej e frymëzuar nga ikona, Audrey Hepburn. Almeda Abazi nxori një foto ku tregonte se diçka të ngjashme ka veshur edhe ajo përpara Lady Gaga-s dhe kujton se frymëzimi ishte po Audrey, që me fustanin e zi të ngjitur pas trupit dhe dorezat deri tek bërrylat, bëri epokë në kohën e saj!



## Shpërthen aktorja shqiptare: Veshja e Lady Gagës ishte e kopjuar, ja provat



**P**ara dy ditësh publikoi një foto me hashtagun "Sa shumë të paskam dash", ndërkohë që dje, fillimisht këngëtarja postoi një video 7 i ri. Në video shfaqet vetëm këngëtarja e veshur me kanatiere dhe xhakëtë xhins, teksa qëndron para një vendi me gjelberim. Më vonë e saj të dytë dëgjohet edhe muzika dhe bëhej fjalë për një ndërthurje mes një balade dhe rrymës pop. Një këngë, e cila mori shumë vlerësime që në fillim dhe pëlqimet në "Youtube" arritën 4 mijë në pak minuta. Një këngë shumë e ndërjerë kjo, e sjellë nga Elvana, të ketë vallë lidhje me ndjesitë e saj të shkuara?

## "Tavolina e mërziisë", Elvana Gjata publikon këngën e shumëpritur

# BULEVARDI

## POLITIK

Na merrni seriozisht!

### Rama tradhton Juventusin me Liverpoolin dhe pa dashje shkel ligjin e ndalimit të basteve

Qeveria ka shpallur me forcë aksionin për mbylljen e lotove, ose të quajtura si baste sportive. Aksioni u finalizua me miratimin e ligjit për mbylljen e të gjitha pikave të lotove, duke paralajmëruar se kush kapet me ushtrimin e këtij aktiviteti të paligjshëm do të ndëshkohet. Madje, ligji i ri ka përcaktuar edhe ndalimin e reklamave të kompanive të basteve. Por pavarësisht këtij angazhimi, kjo dispozitë e ligjit nuk është zbatuar siç duket edhe nga vetë kryeministri Edi Rama, i cili me xhupin e tij sportiv që ka veshur këto dy ditët e fundit edhe në aktivitete publike duket se ka bërë një autogol. Kryeministri ka mbajtur të veshur një xhup sportiv me logon e LFC, të klubit të famshëm të futbollit anglez, Liverpool. Por bashkë me logon LFC, shoqërohet edhe me reklamën e 'BetVictor'. Pikërisht të një kompanie bastesh, sponsori zyrtar i Liverpoolit. Në këtë rast jo vetëm që ka tradhtuar Juventusin me Liverpoolin, por edhe pa dashje ka shkelur edhe ligjin që ndalon bastet.



### Erion Braçe nuk është ambientuar ende me postin e ri të zëvendëskryeministrit

Erion Braçe është një nga politikanët me më shumë mandate deputeti në Kuvendin e Shqipërisë. Por pavarësisht jetëgjatësisë së tij politike, ai nuk kishte qenë asnjëherë më parë në një pozicion ekzekutiv. Ndërkohë që prej pak më shumë se 1 muaji, ai është futur për herë të parë në qeveri dhe me një post goxha prestigjioz, atë të numrit 2 të kabinetit qeverisës.



Por, duket se përshtatja me këtë detyrë të re dhe kalimi nga roli i atij që kërkonte llogari për çdo gjë në postin e zëvendësministrit, duket se përbën një proces të vështirë për të. Dhe këtë ai nuk nguron ta evidentojë edhe vetë. I ftuar në "A show" në "News 24", ai nuk ka nguruar ta shprehë këtë ndjesi të veçantë që e ndjek prej më shumë se 1 muaji. "Edhe pse kam 1 muaj e gjysmë në detyrë, ende nuk jam ambientuar me titullin zëvendëskryeministër. Se si më duket. Sidomos me njerëz që i njoh e më njohin kur më thërrasin me këtë titull se si më duket", - tha Braçe.

Gjithashtu, ai tregoi se detyra e re e ka detyruar që të heqë dorë edhe nga shumë pasione, si letërsia apo ndjekja e futbollit.

### Ish-anëtarja e stafit padit Trump: Më puthi pa dëshirë

Një anëtare e stafit të fushatës presidenciale të vitit 2016 të Donald Trump ka pohuar se presidenti amerikan e puthi pa pëlqimin e saj gjatë një tubimi në Florida. Alva Johnson ngriti padi ndaj Trump dhe pohoi se ai e kapi për dore dhe tentoi ta puthte në buzë gjatë tubimit në Tampa më 24 gusht 2016. Johnson pretendon se në atë moment ktheu kokën dhe puthja përfundoi në cep të buzës. "U ndjeva e dhunuar, sepse nuk e prisja kurrë këtë gjë", - tha ajo në një intervistë për "The Washington Post". "Ende më kujtohen buzët e tij që afroreshin tek unë".



### E stresuar nga Brexit, Theresa May luan bilardo me homologun evropian

Kryeministrja britanike, Theresa May, shprehet se pret të marrë sugjerime nga udhëheqësit evropianë për procesin e Brexit. Por kryeministrja e Britanisë, Theresa May, ka zgjedhur të marrë disa leksione bilardoje nga homologu i saj italian, Giuseppe Conte. Gjatë samitit midis Bashkimit Evropian dhe Ligës Arabe në Egjipt, ajo ka shfrytëzuar rastin për të luajtur pak momente bilardoje me ftesë të kryeministrit italian, Giuseppe Conte. Duket se Conte ka avantazh në këtë rast, pasi May e ka të vështirë të gjejë edhe pozicionin e mbajtjes së stekës.



## Këshilla

**E** bardha e vezës, vaji i ullirit, lëngu i limonit, frutat dhe perimet, përveçse janë ushqime shumë të shijshme, janë edhe një "ilaç" i mirë anti-rudhë. Kremrat dhe produktet antirudhë janë zgjedhja e parë e shumë grave për të shmangur rrezikun e rrudhave. Por, këto produkte nuk janë të vetmet, sepse është zbuluar që disa produkte ushqimore ndihmojnë për të luftuar rrudhat në mënyrë mjaft të natyrshme. Të shohim se cilat janë ato...

**E BARDHA E VEZËS**

Ndani të bardhën e vezës në një tas. Masazhoheni këtë përbërje mbi lëkurë dhe lëreni të thahet për të paktën 15 minuta. Më pas shpëlajeni me ujë të vakët. E bardha e vezës përmban vitamina E dhe B, të shkëlqyera kundër përkeqësimit të membranave qelizore dhe për mbrojtjen nga rrezet e dëmshme të diellit UV.

**VAJI I ULLIRIT**

Karakteristikat e vajit të ullirit janë të njohura, ai e ndihmon lëkurën që të qëndrojë e butë dhe e mbrojtur. Proveni të masazhoni lehtësisht disa pika vaji në fytyrë përpara se të shkoni të flini dhe më pas mbulojeni atë me një peshqir të butë.

**FRUTAT DHE PERIMET**


Frutat e freskëta dhe perimet, në përgjithësi ato me vitaminë A dhe D kontribuojnë për ta mbajtur fytyrën të freskët dhe të tonifikuar. Mungesa e vitaminës A është një nga shkaqet e tharjes epidemike, pra edhe të formimit të rrudhave. Vitamina A stimulon prodhimin e kolagenit, favorizon rigjenerimin qelizor, ndriçon tonin e fytyrës dhe heq njollat e errëta të formuara nga dielli apo nga mosha.

**LËNGU I LIMONIT**

Prijeni lëngun një kokrrë limoni në gjysmë dhe masazhoheni një pjesë mbi rrudhat e fytyrës. Aciditeti i lëngut të limonit e bën lëkurën më të lëmuar dhe zvogëlon shfaqjen e rrudhave. Nëse e aplikoni të freskët, limoni ndihmon edhe për zbardhjen e njollave të lëkurës falë përbajtjes së acidit asorbik.



## Fytyrë pa rrudha? Ja ushqimet më të këshilluara për një pamje gjithnjë rinore



## INMEMORIAM

# Sadije Agolli

## Gruaja që nuk u mësua kurrë me ikjen e të shoqit

Fatmira Nikolli

Unë e kam ndërë shumë mu ngesën e tij, do doja që të kisha mendimin e tij. Për çdo gjë unë flisja me të". Vetëm në fillim të muajit, Sadije Agolli, e veja e shkrimtarit Dritëro Agolli fliste kështu për mallin 2-vjeçar për të shoqin. Në përvojtorin e ikjes së tij, ajo ndjente se kjo mund të ishte intervista e saj e fundit dhe "linte amanet", që shtëpia e tij të kthehej muze, siç parashihet një projekt i Bashkisë së Tiranës. I ishte dashur shumë kohë të pranonte që ta linte këtë shtëpi e ta jepte për muze. "Këtu është gjithë jeta ime, të gjitha kujtimet e mia. Unë nuk mund të jetoj jashtë saj", qe shprehur ajo në fillim kur iu propozua nga bashkia. Ju deshën dy vite për ta pranuar që shtëpia e saj, nuk mund të ishte vetëm e saj dhe se shkrimtari duhej t'u përkiste të gjithë. Por bash kur e pranoi që duhej të linte shtëpinë, ajo iku në mënyrë të pakthyeshme, duke lënë pas shtëpinë, kujtimet, mallin dhe familjen. Iku pranë Dritëroit, me mungesën e të cilit nuk u mësua kurrë.

Ajo u nda dje nga jeta tek Neurologjia në QSUT, pas një hemorragjie cerebrale.

Ndonëse të jepte imazhin e një gruaje të fortë, siç në të vërtetë ishte, ajo u shua, pothuaj "papuritur" për shumëkënd.

Ishte 76 vjeçe dhe iku 2 vite pas të shoqit, shokut të saj të jetës, shkrimtarit të saj më të dashur, njeriut me të cilin ndau jetën dhe i qe redaktore.

Lexuesja e parë e shkrimtarit, ajo kalonte net të tëra mbi makinën e shkrimit, për të radhitur ato që Dritëroi shkruante me shkrim dore nëpër letra. Asaj iu kushtuan poezi pa fund dhe kushtime nga Dritëroi derisa ai mbylli sytë. Ajo i rrinte pranë në dhomën e drunjtë e priste e përcillte miqtë e tij devotllit, mbushte gotat e rakisë dhe ishte mendja e tij dytë. Ishte, një dashuri e bukur 52-vjeçare.

Jetoi me kujtimet e tij, pa mundur ta pranonte ikjen, jetonte me porositet e personazhet e të shoqit.

"Këtu ka shumë gjëra që mund të mësojnë njerëzit, kushdo që vjen. Është jeta e tij, puna e tij, e pas-

*Shuhet e veja dhe redaktorja e Dritëro Agollit, planet që la në mes e malli që nuk u shua*

*Ajo mezi u bind ta jepte shtëpinë për muze dhe jetoi në të deri ditën e fundit*

qyruar në vepra, në gjithë këtë që shihni ju. Por edhe të tjerët mund ta mësojnë jetën e tij, si shkrimtar, si njeri edhe si artist. Përveç bibliotekës që e kemi shumë të pasur, ka piktura edhe skulptura, secila prej tyre mbart një kujtim", thoshte Sadija për shtëpinë e tyre në pallatin me kube.

"U prehsh në paqe, Sadije Agolli, gruaja që rrezatoi fisnikëri dhe dinjitet përkrah patriarkut të letrave shqipe Dritëro Agolli, e në këtë udhë jo fort të lehtë, Sadija ish jo vetëm një dëshmitare dhe njëherazi qëndrestare kurajoze, por edhe një kapitull me vlerë i Historisë së Letërsisë Shqipe", tha dje studiuesi Ermir Nika.

### NJOHJA E ÇIFTIT

"Jemi takuar herën e parë në



dasmën e Elena dhe Ismail Kadarese, pastaj disa herë në Lidhjen e Shkrimtarëve. Më pëlqeu ai njeri që bënte jetë boheme me pije, humor e shokë. Kështu u miqësua. Shkova disa herë edhe në shtëpinë e tij, u njoha me prindërit, derisa një natë vendosa të qëndroja aty dhe kësajori e ndava mendjen të bëhesha gruaja e tij", pati rrëfyer vetë Sadija dikur. Në fillim

kur shkrimtari asokohe në moshën e Krishtit, 33 vjeç, i shkruante të dashurës së zemrës. Sot, kur asnjëri nuk është më, libri merr tjetër peshë.

### GRUAJA QË NUK U MËSUA KURRË ME IKJEN

"Lamtumirë Sadije! Pa ty s'do kishim Dritëroi! Kur rreth një muaj më parë, në ekranin e celularit mu shfaq emri i Sadije Agollit, hezitova



Në foto: Sadije dhe Dritëro Agolli

va një sekondë për ta hapur. Pas vdekjes së Dritëroit, e merrja herë pas here, derisa besova se kishte nisur që të mësohej me mungesën. Por, kur bisedova një ditë me Elonën, më konfirmoi të kundërtën. Atëherë mendova se kisha të drejtë që kisha krijuar idenë se ishin një çift i lidhur aq

Ilkja e çiftit Agolli na e varfëroi qytetin. Breza të tërë shqiptarësh u rritën e jetuan me librat dhe bisedat, për historinë e jetës së tyre të jashtëzakonshme. Lamtumirë Sadije!", shkruan Peza.

Vajza e Feim Ibrahimit, Ertrita dhe njëherësh fqinje e familjes Agolli, në një postim në "Face-

### Poezia

*Sikur të vëzohet në mal ky avion,  
Kur unë udhëtoj nga Greqia,  
Askush s'e mbaron.*

*Hetarkën përgjysmë me vjershat e mia.*

*Atë do ta hapë Sadija e mjerë,*

*Padashur, ashu kat së kalit,*

*Mbi vjershën e lënë përgjysmë do bjerë,*

*E nxehta pikëz e latit.*

*Pastaj do ta nxjerrë nga çanta shaminë,*

*E vetme në dhamë,*

*Hetarkën do ta mbyllë me një psherëtimë:*

*"O shkreti, i linte gjërat përgjysmë gjithmonë!"*

*Dritëro Agolli*

pazgjidhshmërisht, sa prej shumë vitesh ishin bërë 'vëlla e motër siamezë'. Jo vetëm që kishin marrë tiparet, të mirat dhe huqet e njëri-tjetrit, por edhe frymën me sa duket, e merrnin për njëri-tjetrin", shkroi dje Alfred Peza. Kujtonte se pasi ngriti celularin, Sadija e vërtetoi ngurrimin e tij. "Pasi mu ankua miqësisht siç dinte veç ajo, për 'harresën', më kërkoi që të shkruaja kujtimet për Dritëroin, si pjesë të projektit të saj më të ri, me miqtë e tij. Krallë qëllon të takosh një grua që jeton për bashkëshortin, me përkushtimin e një nëne dhe 'engjëllit' të tij mbrojtës. Ikja brenda dy vjetësh nga ai tregoi se dashuria e tyre si nëpër filmat e neorealizmit italian, kishte në ADN-në e saj, pafundësinë e të gjitha ngjyrave shqiptare.

book", shkroi dje "Lamtumirë teta Sadije". Duke e cilësuar se mike ideale të "xhaxhi Dritëroit" dhe prindërve të saj, Ertrita e shihte Sadijen si një grua të rrallë. "Jetove edhe pak për Lonën, Tanin, nipat e mbesat e tua, por realisht ti doje të shkoje menjëherë afër xhaxhi Dritëroit dhe ja, tani e gjete momentin dhe shkove! Më kujtohet, kur të takoja e më thoshe që nuk mund ta pranojë që ai kishte ikur, ndërsa unë të thosha që duhej forcë sepse kishe fëmijët", shkruan ajo. Kujton mandej se Sadije vendosi të pranojë ta japë shtëpinë për muze, "por ndoshta nuk mundeshe ta lije atë për së gjalli, prandaj edhe zgjidhje të ikesh kështu pa zhurmë, pa dhimbje, duke i marrë të gjitha kujtimet e tua me vete, pa lënë asgjë dhe duke i lënë të gjitha".

# Tani mund të bësh atë që pëlqen

## Kujtimet të profesor Gëzim Qëndros

Nga Arian Leka

Në pranverën e vitin 1940, At Donat Kurti botoi në revistën 'Hylli i Dritës' një përrallë, në të cilën tre miq - Musha, Bokshi dhe Tokshi - bëjnë çmos për ta risjellë mikun e tyre sërish në jetë. Detyrë ca e vështirë edhe për vetë Jezu Krishtin, por jo krejt e pamundur, për aq kohë sa njëri prej tyre kishte dhuntinë e rrallë të punimit të eshtnave, tjetri të rikrijimit të korpit dhe i treti që dinte t'i jepte mikut frymë jetësjellëse.

- Të kishte kush me ta dhanë frymën e me t'i luejtë gjymtyrët, unë...

Por, qoftë edhe pa dashur, kujtimet për miqtë prirën të marrin trajta nekrologjike, të sentimentalizohen e, pas kësaj, nuk është gjithmonë e lehtë ta mbash patetikën larg. Ndaj, më shumë se sa copëza bisedash dhe pamjesh, më grish formula e tre miqve, që mëtojnë diçka tjetër.

Sjell ndërmend me këtë rast edhe miq të tjerë që, në këto muaj, u përfshinë në një proces të ngjashëm rikrijimi. Duke dhënë nga vetja fjalë, për ta mbajtur kësaj ane një mik të çmuar si Gëzim Qëndro, me siguri që secili prej tyre mund të ketë përsëritur pakashumë të njëjtën formulë e do të kenë provuar të njëjtat ndjesi:

- Të kishte kush me ta dhanë frymën e me t'i luejtë gjymtyrët, unë...

Veçse për ta rikrijuar përmes kujtesës një njeri si Gëzimi, lipset së pari një s'meion. Nga njëra anë s'meion-i do bëhej shenjesja në gjurmë, që duhet ndjekur për ta kthyer kohën pas dhe për të pikasur zanafilat e tij.

Nga ana tjetër, s'meion-i duhet të ofrojë edhe sigurinë se djaloshtit të dikurshëm dymbëdhjetëvjeçar (atij "me dosje vizatimi në dorë, me ndrojtjen mos bëjë zhurmë, që shëtiste nëpër sallat thuajse gjithmonë bosh" të Galerisë së Vjetër të Tiranës dhe që vështronte nga kangjellat "tempullin e shkrimtarëve" të qoshku i Rugës së Kavajës) nuk i trazohet magjepsja nga mrekullia e artit, që e shoqëroi gjatë gjithë jetës.

Sot nuk tingëllohet dhe aq mistik mendimi se itinerari ngulmues mes Rugës "Fortuzit" dhe Rugës së Kavajës, ka qenë përcaktues për udhëtimin që Gëzim Qëndroja do të kryente më pas.

I tendosur si urë midis tekstit dhe artit viziv, rituali i përditshëm drejt Galerisë dhe Lidhjes së Shkrimtarëve duket sikur del prej poezisë së Robert Frost-it, "The road not taken", për të marrë pamjen e atij njeriu, që dhuket të zgjedhë. T'u bashkohet turmave që gëlojnë, apo të ecë fill vetëm, duke paguar shpëgim për modelin, që një shoqëri si e jona nuk e mirëpret? E shkurtër jeta. I befë këto vendime. Dhe thuajse e pamundur të zbulosh se çfarë mund të ndodhë, nëse merr njëherë prej rrugëve dhe të pas dore rrugën tjetër.

Pikërisht këtu hyn në punë EUREKA. Por a do të ishte kjo, fjala e duhur, që do e sillte të plotë personalitetin e Gëzim Qëndros? Ndoshta jo plotësisht, por ajo mbetet një nga më të gjeturat. Ndaj dhe çdo gjë që ideonte, shkruante apo krijonte, vetëm apo në bashkëpunim me miqtë, ai kishte dashur ta niste me atë fjalë.

Kjo EUREKA e hidhte Gëzim Qëndron si fëmijë të mahnitur në Botë, sa herë që, "duke u gëzuar shumë dhe duke u habitur jo pak", arrinte t'i avitë së vërtetë të cilën, pakush para tij, megjithëse mund ta kishte pikasur, nuk kishte mundur ta gjurmonte dhe ta interpretohte me aq thellësi.

Një EUREKA ishte dashur të bëhej themel për veprat Gjuha pamore, Surrealizmi socialist, Arkeologjia e mëngjesit, Kinostudio Shqipëria e Vjetër, por besoj se kishte nisur herët dhe ashtu kishte ndodhur thuajse gjithmonë. Ndoshta që kur revista PamorART dhe ekspozitat Homo Socialisticus, Surrealizmi socialist, Post EVA dhe Nostalgi merrnin formë.

Me po atë ndjenjë zbuluese ishin veshur



edhe studimet e Gëzim Qëndros mbi krijimtarinë e Edi Hilës, kritika mbi thanatologjinë në skulpturën monumentale të Odise Paskalit, përmasa njerëzore e përditësisë dhe e normalitetit të vepra e Edmond Gjikopullit apo aura kripto-teleologjike në tablote e Enkelejd Zonjës.

Prej asaj lënde ishte ngjizur edhe monografia mbi krijimtarinë e çmuar të Rexhep Ferrit apo pikasja e realizmit brenda njëherë prej pikturave më të hershme të "ikonës romantike" të artit shqiptar, si Çeta e Shahin Matraku, të Spiro Xegës, shtjelluar bindshëm në librin studimor Heronjtë janë të uritur.

Por njerëzve të arteve pamore ndërkohë u mbeten nëpër duar e nëpër gishtërinj s'meion-e, gjurmë boje apo grima argjile, prej të cilave ngjizen vepra të tjera, po aq të vëra sa ato që përmenden zakonisht. Gjithkush që nxjerr nga biblioteka librat Nga Parahistoria të Mesjeta (2005); Arti: prej zanafilës të Van Gogh (2005); Histori e ilustruar e botës (2006); Pesë fytyrat e modernitetit (2012); Biseda me Kafkën (2012); Problemi i objektit në antropologjinë (2012); Fuqia e imazheve (2013) apo Arti dhe mjeshhtëria e bukurisë (2015), nuk bën gjë tjetër përveçse i jep dorën me mirënjohje dhe nga një tjetër perspektive përkthyesit të shkëlqyer Gëzim Qëndro.

Ars longa. Vita longa. \*\*\*

A mund të nxjerrim prej miqësisë ato përfitime të paçmueshme, të tilla si njohjet, bisedat dhe bashkëpunimet, pa ditur më parë se ç'është një miqësi dhe pa vlerësur gjithçka të mirë që vjen prej saj? Sot jam në një mendje me atë që kam mësuar prej Ciceronit te de Amicitia, vite më parë se të njihesha me Gëzim Qëndron, mikun me cilin kam ndarë mendime mbi dijen, kulturën, letërsinë, muzikën, filozofinë antike, filozofët dekonstruktivistë, qytetërimet, semiotikën, artin botëror, antropologjinë, mbi të kaluarën dhe mbi përditshmërinë shqiptare.

Megjithëse me formime të ndryshme, me kohë u kuptua se bashkëbisedimi - peripatetizmi siç e quajmë disa - ishte diçkaja e përbashkët, që duhej ndarë në ecje mes nesh dhe mes miqtë të tjerë, pavarësisht se disa prej tyre ishin ende në këtë anë të

jetës dhe të tjerë e kishin "tepruar", duke e kapërcyer kufirin mes botëve.

Nuk dua t'u kundërvihem e, aq më pak, t'i zhgënjëj ata që besojnë se miku njihet në udhëtim. Ka qenë një i tillë (i papërsëritshëm, ku së bashku me Gean, Artën dhe Profesor Matteo Mandala, morëm pjesë në Panairin e Librit të Laipzigit, ut, siç ka qenë edhe një i dytë në Prishtinë, me rastin e hapjes së ekspozitës së Luan Mulliqit), por nuk dua të ndalem këtu.

Gëzim Qëndron e kam njohur në Tiranë dhe ky topos, me të mirat e me të këqijta e tij prej kryeqyteti normal, që ndërkohë shënohet në rrjedhat e veta jo pak gjurmë urtësie, absurdi e marrëzie, si dhe momente lufte e caste paqeje, ishte hapësira e ngushtë brenda së cilës ai ndihej i lirë.

Këtu kam pasur rastin të vërej se Gëzim Qëndroja ishte bashkëbisedues i rrallë, një ndër fare të paktët njerëz që, edhe pse e di fort mirë se e zotëron artin e ligjërimit, pëlqente t'i jepte vlerë heshtjes dhe të shndërrohej në dëgjues kureshtar.

Kam dashur të besoj se ajo dhunti ushtrrohej për t'i dhënë bisedës hapësirë dhe që dialoguesit të kishte zërin e tij, sa herë që bisedohej mbi riinterpretimin e realizmit socialist në pikturë, letërsi dhe kinematografi, mbi heterotopinë, fenomenologjinë, simulacrum-in, Dasein-in e përvojës, origjinën e humbur të gjendjeve tona, apo kujtesën, që e rikthen qenien të fillimit. Kjo ngaqë për Gëzim Qëndron kultura nuk ishte vetëm një mënyrë jete-se, por një vendbanim.

Nga fotot e rralla që kanë mbetur prej kohës së ligjëratave të tij në auditorë, nuk mund të thuhet me saktësi se cilës botë i përkiste më tepër, kur vihej përballë studentëve. Dallohet aty një farë përhumbjeje, si ajo që rri pezull mbi fytyrat e atyre, që sapo kanë dalë prej një planetariumi apo observatori kozmik.

Pamja prej të porsambërrituri nga botët, dhe si e grishnin, e bënte të pashmangshme përshtypjen se ai njeri, me këmbët në tokë dhe me kokën si një shtëllungë reje, sapo ishte kthyer nga visoret e mendimit, ku kishte takuar paraardhësit, farefisin.

Dhe, si të donte ta përligjte se kishte qenë përnjimend Andej ai hidhte mbi bisedë fragmente idesh prej mendjeve të

ndritura. Martin Heidegger, Jacques Derida, Friedrich Nietzsche, Julia Kristeva, Michel Foucault, Platon, Gilles Deleuze, Hannah Arendt, Spinoza, Kierkegaard, Pierre-Félix Guattari, Simone de Beauvoir, Leibniz, Francis Bacon, Bertrand Russell, Svetlana Boym, David Hume, Marcel Proust, Zaha Hadid, Simon Blackburn, Franz Kafka, Ludwig Wittgenstein, Boris Groys, Jean Baudrillard, Immanuel Kant, Don Kishoti me Sançon, Zyojlo dhe Demka, Ana Karenina, Hakëlberri Fini, Çiçikov, Jozef K, Raskolnikov, Doktor Gjilpera, Henri IV, Xivo Gavo, Shvejku, prej të cilit kujtonte shpesh skenën komike të ushtarëve që u ngjasonin dallëndysheve. Nuk ishte e përveçme që e bënte këtë. E rrallë ishte se e bënte me modesti.

Miqtë, familjarët e afërt dhe sidomos studentët mund ta kenë përgjigjen përse ai pëlqente shoqërimin në të pavdekshmit dhe pse e shihim të qëndronte gjithmonë më gjatë përballë një pikturë, sesa karshi një ekranit të shogët TV-je; pse e ndeshnim më shpesh në bibliotekë, sesa në kafene; përse kohën më të çmuar e kaloi i përlulur, si shërbesëtar, mbi libra dhe mbi tekstet e tij, të cilët ishin në të njëjtën kohë edhe tekste për të tjerë.

A thua e kishim kuptuar se një prej dhuntive të tij ishte të qenurit pajtor, ndërmjetësimi mes emrave të ndritur të botës dhe rishtarëve, që sapo kishin trokitur në portat e dijes? Mund të thuhet se mes mundësive të ofruara për të qenë "prezent", ai kishte zgjedhur më të besueshmen dhe më të vështirën, si të ishte përjashtimi i rregullit të jetës plot zulme? Kishte dhënë "dorëheqjen" nga balalietit i të jetuarit përceptisht, në shkëmbim të një fluturimi drejt njerëzve me të cilët ndihej si në shtëpi?

Megjithëse në censurën e fundit ishte deklaruar agnostik - njeri që, me fjalë të tjera, e pranon, por jo si diktat, misterin e krijimit - mund të hamendësojmë se, në ka pasur ndonjëherë një lutje të gjatë, që Gëzim Qëndroja ia ka drejtuar Krijuesit, ajo mund të ketë qenë e lidhur me çlirimin prej zillisë, zemëratës, pafytyrësisë, të mos lakmojë tjetër pos ajoj që ishte e tij, gjetjen e një vendi mbi palët e mes të urtëve dhe përdorimin e dijes si mjet për të na bërë njerëz të mirë.

Shumë për një njeri. Gjithë sa mbetet sille me një ndjenjë të hollë humori, shpesh vetëqortimi dhe vetëqesëndie, e cila mund të mbyllet me shprehjen "je suis en guerre contre moi-même" apo me argumentin e Pranisë përmes Mungesës.

Gëzim Qëndroja e gjente gjithmonë një EUREKA për ta filluar përmes një zbulimi veprën e tij. Tani, kur mungesa dhe sidomos prania nuk është më pengesë dhe as mundësi, të gjithë ata që njohën kanë rastin të përjetojnë zbuluesën - EUREK-ën e tyre - duke rinjohur jo thjesht personin, por personalitetin e tij.

Nuk mund ta di nëse ishte krejt e rastit apo jo, që konceptet prani dhe mungesë zunë aq shumë vend në tekstet dhe ligjëratat e Gëzim Qëndros, sa që sot duket sikur përkufizojnë jo vetëm mënyrën se si ai jetoji, por sikur kështillojnë edhe qasjen ndaj kujtimit dhe trashëgimisë së tij të begatë si krijues, kritik artit, shkrimtar, skenarist, përkthyes, autor filmash vizatimorë, si pedagog, si mik e, mbi të gjitha, si mjeshër i krijimit të empatisë në mjedise ku fjala ka vlerë dhe në auditorët, ku ai formoi disa breza studentësh - pasardhësit e tij shpirtërorë, të cilët, sikur të trashëgojnë pak nga dhuntitë e tre miqtë të përrallës, që At Donat Kurti botoi të 'Hylli i Dritës', në pranverë të vitit 1940, do i thoshin:

- Tani mund të bësh atë që pëlqen. (Marrë nga "Poeteka").

Dje në 'Deutsche Welle'

# Kur meritokracia zëvendësohet nga paraja ose partia

Nga Lindita Arapi

*(vijon nga faqja 1)*


...së përgjegjësisë, njerëzit vërtet mësohen me të keqen, por humbasin besimin tek ata që kanë në krye. Shoqëria m'pakët e rritet dëshira për t'u larguar nga një vend, siç po ndodh në Shqipëri. Ankesa më e shpeshtë - ky është një vend, ku postet nuk merren me meritë. Skandali i fundit i plagjiaturave që goditi si një dallgë e re e ftohtë shoqërinë e forcoi edhe më shumë këtë mungesë meritokracie. Jo se fiktiviteti nuk njihet, por përmasat e tij e nivelet që kapte ishin shokuese.

Radhazi dolën në media kapituj doktoraturash të kopjuara, diploma fiktive, zbulime deklarimesh të pasakta për studime në universitete. Personat pas tyre ishin ndër emrat më të njohur të Shqipërisë. Deputetë, funksionarë të lartë, zëvendësministra, një ish-ministre, një ministere e qeverisë aktuale. "Numri i individëve me diploma të diskutueshme është rreth një e treta e parlamentit, numri i individëve që është provuar që kanë diploma fiktive, tituj fiktivë ose kurse fiktive të deklaruara është provuar të paktën në 10-15 raste", thotë drejtori i Institutit të Studimeve Politike, Afrim Krasniqi, i marrë gjatë me këtë temë. Që praktikisht do të thotë se në Shqipëri tanimë një kastë politikanësh me integritet të dyshimtë merr vendimet për një popull që pret kaq shumë nga politika. Për shkrimtarin e njohur, Moikom Zeqo, një nga deputetët e parlamentit të parë pas rënies së diktaturës, ky është "një mashtrim kombëtar". Në një intervistë për gazetën "Dita", ai e cilëson këtë fenomen në politikë si fabrikim të personalitetëve të rremë.

### Të zbulurohem me tituj për të rritur prestigjin

Plagjiatura, një virus që prek më shumë politikantët? Politologjia e Shoqatës Gjermane për Politikën e Jashtme, që merret me Ballkanin Perëndimor, Dr. Natascha Wunsch thotë për DË, se "titujt si ai i doktorit shkencor shihen në shumë vende si një kualifikim pozitiv për poste publike, e kjo i shtyn herë pas here politikanët që gabimisht të duan të zbulurohen me tituj të tillë dhe/ose të dorëzojnë edhe plagjiatura."

Edhe në Gjermani pati disa raste të zbulimit të plagjiaturave, nga qytetarë që i verifikuan rastet e dyshimta, por ato rezultuan me disa heqe tjetra dhe me dorëheqje, madje edhe të ministrit german të Mbrojtjes Karl Theodor zu Guttenberg dhe ministrës së Arsimit Annette Schaaen asokohe. Në Shqipëri, veç dorëheqjes së një zëvendësministri arsimit, publikimit e plagjiaturave me fotografim të kapitujve të kopjuar janë mohuar nga gati të gjithë emrat e përmendur të deputetëve të parlamentit shqiptar. Edhe ministrja e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu i mohoi akuzat për plagjiaturë. Shkrimtari dhe ish-deputeti, Moikom Zeqo kërkon hapur



dorëheqjen për raste të tilla. "Cilido deputet që ka marrë një titull që është vërtetuar plagjiatura, duhet të japë menjëherë dorëheqjen."

Qeveria zyrtarisht e dënon fenomenin, por sipas drejtorit të Institutit të Studimeve Politike, Afrim Krasniqi qeveria nuk i kush-ton rëndësi të madhe, megjithëse aktualisht kemi një ish-ministër dhe një ministër aktuale me diploma fiktive. "Paradoksi bëhet edhe më absurd, kur zyrtarisht qeveria ka mbajtur retorikë kundër fiktivitetit në titull dhe karrierë...e në krahasim qendrojnë ministra të akuzuar për plagjiatura."

### Si u futën "të fortët" në politikën shqiptare?

Por pika e kthesës në politikën shqiptare, kur madje në parlament u futën jo vetëm njerëz me diploma jo të marra me meritë, por edhe elementë kriminale, që siç dihet, shkaktoi debate për vite me radhë, i ka rrënjët më të thella. Politologu Afrim Krasniqi shpjegon se në një moment të caktuar, kur politika kishte probleme përfaqësimit, ajo iu afrua njerëzve që njihen si "të fortët", biznesmenëve të tranzicionit. "Ata kishin dy cilësi, dominimin në zona elektorale dhe parandë, por jo statusin social. Këtë ata u munduan ta krijonin përmes CV-ve fiktive." E për shkak se Parlamenti Shqiptar e merr si të mirëqenë deklarinë e deputetit dhe nuk bën verifikime të mëtejshme, valën e fiktivitetit që iu sul parlamentit shqiptar këtu vite nuk e ndali kush.

Nuk e ndali as Ministria e Arsimit. Kërkesës së Institutit të Studimeve Politike kjo ministri, i përgjigjet se ka të drejtë të verifikojë vetëm individët që kanë trokitur në ministri dhe kanë bërë regjistrimin me sjelljen e diplomave. "Kur i kemi paraqitur listën

e deputetëve me diploma të deklaruara, ata na kanë thënë, nga këta kaq persona kanë deklaruar dhe ia kemi njohur, për të tjerë që nuk kanë bërë kërkesë nuk mbajmë përgjegjësi.", thotë Afrim Krasniqi. Vërtet që Ministria e Arsimit e ka një rregullorë për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve. "Ministria siguron software për kontroll automatik apo pajisje të tjera që i shërbejnë kontrollit për plagjiaturë", thuhet në një nga vendimet e Këshillit të Ministrave të vitit të kaluar, por duket se këto janë më shumë fjalë të bukura në letër.

### Dëshitimi i institucioneve përgjegjëse për produktin shkencor

As institucionet më të rëndësishme të verifikimit të vërtetësisë e cilësisë së produktit shkencor, universitetet nuk kanë arritur me sa duket ta kryejnë detyrën e tyre. Universitetet duhet të bëjnë verifikimin e secilit nga rastet e përmendura, por universitetet nuk e bëjnë, thotë Afrim Krasniqi. "Sistemi është shumë i mbyllur; bordet dhe drejtuesit e universiteteve zgjidhen nga qeveria. Ata janë zyrtarë të vegjël, ndërkohe që akuzat janë bërë për nivele të larta."

Nuk ishin universitetet, ato që zbuluan skandalin e plagjiaturave në diplomant apo doktoraturë dhe politikanëve, por individë të angazhuar. Vladimir Kola, i cili ka përfunduar doktoraturën për të drejtën publike në Itali është njëri nga personat, që zbuloi një seri plagjiaturash, me tyre edhe të politikës. Për Deutsche Eellen ai shpjegon pse i hyri një rrugë të tillë: "Motivët janë të shumta, por së pari nga fakti se në konkurset, ku kam konkuruar për personel akademik, kam

vënë re qartazi mungesë meritokracie dhe serioziteti, ku kandidatë pa doktoraturë apo pa ndonjë shkrim shkencor me cilësi, gjendeshin të listuar të fituesit, apo të punësuar, ndërsa të tjerë me doktoraturë, si në rastin tim, nuk dilnin fitues. ...Jam shtyrë të zbuloj plagjiaturat e ndryshme, pasi kam vënë re se kishte edhe interes publik mbi probleme të tilla."

### Fenomeni i masterizimit

Fenomeni nuk është i pranishëm vetëm në politikë. Sipas Vladimir Kolës "fenomeni është i pranishëm tek të gjitha kategoritë, por natyrisht njerëzit që janë të pushtetshëm, në përgjithësi "gardhin" që duhet të kapërcesh për të marrë doktoraturën e shohin ose e kanë më të ulët se të tjerët."

Ky fiktivitet shqetësues në Shqipëri duket se rrënjët i ka ekonomike. Ka qenë një ligj i arsimit të lartë i vitit 2007, i cili i hapi rrugën masterizimit masiv të viteve të fundit, "sepse doli një vendim i Këshillit të Ministrave, sipas të cilit individët që kanë gradë shkencore në mënyrë automatike nëse punojnë në administratën publike marrin rritje rroge. E pothuaj se e gjithë administrata publike qendrore u fut në master apo nivele të tjera të kualifikimit", shpjegon Afrim Krasniqi.

Një master sillte rrogë më të mirë, edhe nëse ai nuk bëhej në profesionin që ushtrohej. Një master të ndihmonte të ruajë vendin e punës. Reforma e re arsimore e ka ndryshuar këtë, por pasojat nuk janë zhdukur. Zhytjen në fiktivitet e pranojnë jashtë mikrofonit të gjithë, por megjithatë një "veting" në këtë drejtim nuk është i

dëshirueshëm. "Fenomeni prek një numër të madh personash. Askush nuk ka interes", thotë Afrim Krasniqi.

### Shija e hidhur e humbjes së besimit

Quo Vadis Shqipëri? Drejt Europës me elita fiktive? Drejt Europës me shtablerje masterash e plagjiatura? "Në Shqipëri është krijuar ideja se gjithë çka shitet, edhe shkenca, i gjithë sistemi krijon impaktin, se kur e kanë bërë këtë, e kanë bërë karrierë, pse duhet ta vrasë mendjen unë, të bëj studime të thelluara, kur e marr të gatshme", kritikon Afrim Krasniqi. Me "ata" nënkuptohen politikanët, elita drejtuese e vendit. Me "unë" të rinjtë që janë në prag të karrierës.

Pasoja - një zhgënjim i madh i brezit të ri për një vend, ku meritokracia zëvendësohet nga paraja apo partia. Protestat studentore të muajit të fundit në Tiranë e shprehën qartë këtë zhgënjim. 79% e të rinjve në Shqipëri duan të largohen nga vendi, sipas një vrojtimi të institutit Gallup. Politologja gjermane, Dr. Natascha Wunsch shikon tek përhapja e rasteve të plagjiaturave rrezikon e deziluzionimit në shoqëri. "Përhapja e rasteve të plagjiaturës jo vetëm varros besimin tek një politikë xhitëse meritokracisë, por ajo mund të ketë si pasojë edhe emigrimin e personave të mirëshkolluar. Ky problem është shumë më i gjerë, sepse në tërësi procedurat meritokratike në vendit në tranzicion nuk janë të zhvilluara mirë, dhe postet publike zihen shpesh me lidhje personale apo përkatësi partiake. Kjo jo vetëm çon në zhgënjim nga popullata, por ka efekt negativ edhe në cilësinë e vendimmarrjes në proceset politike. Prandaj ka rëndësi që të jenë lart në axhendë të reformave politike procedurat transparente në administratën publike."

Kërkohet një mekanizëm efektiv i parlamentit shqiptar, me kompetenca vepruese për të shmangur në të ardhmen infiltrimin e individëve me diploma fiktive, kërkon Afrim Krasniqi. Skandali i plagjiaturave në Shqipëri hodhi edhe një hijë tjetër të errët mbi politikën shqiptare, që vuan nga imazhi i korrupsionit dhe lidhjeve me kriminelin e organizuar. Por e pati edhe një një anë të mirë: Ish-hera e parë që në Shqipëri u fol kaq hapur e gjatë për një problem të tillë. Plagjiaturat i kanë sensibilituar të gjithë. "E kush do të publikojë tani në të ardhmen, apo do të hyjë në politikë, do të ketë vëmendje më të madhe", shprehen Afrim Krasniqi.

Faji i tyre? I këtyre deputetëve kaq të papërgjegjshëm? Që i tmerrrohen vetingut, që i zë ankti dhe makthi natën nga perspektiva e hekurave të burgut? Sigurisht që është edhe faji i tyre. Por jo vetëm i tyre, ama! Psherëtimat dhe ankesat qytetarëve të thjeshtë, të intervistuar në protestën e 21 shkurtit, e dëshmuar këtë. Prandaj dhe këshqeverisë tonë sot duhet të fillojë një gjurmë dhe fort t'i prishet gjumi natën. Ndryshe nuk ka të ardhme të sigurtë ajo dhe vetë vendi ynë.

Opinioni *i* Ditës

# Do kemi një buldozer të dytë?

Nga Fatos Çoçoli

(vrijon nga faqja 1)

...politike normale të vendit. Kjo lëvizje e bën të paqëndrueshëm vendin tonë. Për të provuar të ndihmojmë që vendi të gjejë qëndrueshmërinë politike që ka pasur që nga viti i mbrapshtë 1997, po vijmë sot në Tiranë shtatë anëtarë të Parlamentit Evropian, përfaqësues të grupeve të ndryshme partiake në këtë parlament. Pavarësisht se vizita ka qenë programuar më parë për të vrojtuar përparimin e vendit tonë dhe qeverisë me detyrat e shtëpisë të Brukselit për hapjen e bisedimeve për anëtarësim, kjo vizitë shihet me të drejtë nga shqiptarët si provë për të paqtuar të dyja palët në këtë përplasjen tonë politike të pashoqe në Evropë që nga nëntori i largët i vitit 1922 në Itali (kur u dorëhoq nga parlamenti italian e gjithë opozita). Por ç'do të ndodhë me grupin e eurodeputetëve? Do të takojnë kryeministrin, pastaj kryetarin e pakicës, pastaj disa përfaqësues të shoqërisë civile. Do të japin këshillat e radhës. Ndonjë (i rënë dakord mes grupit), mund të japë edhe ndonjë intervistë në televizionet tona, apo i gjithë grupi konferencë për shtyp. Pastaj do të përgatisin një raport për Komisionin Evropian (qeverinë e BE-së) dhe për Parlamentin Evropian. Me vlerësimin për përgatitjet e Shqipërisë dhe gjendjen e detyrave të shtëpisë që ajo duhej t'i kishte kryer deri tani, përpara provimit të qershorit (vendimit për hapjen ose jo të bisedimeve të anëtarësimit me Bashkimin Evropian). Kaq. Me gjithë pritshmëritë e larta këtu mes nesh, se "këta ndërkombëtarët do të bëjnë diçka". Me këshilla dhe madje edhe shprehje të forta, nuk kändiset njeri nga drejtuesit e partive tona kryesore. Perëndoi koha e ish-Kryeministrit austriak Franc Vranicki, që qëndroi një javë në Shqipëri në mars 1997, duke biseduar me politikanët tanë, dy muaj pasi kishte lënë detyrën si kryeministër. Asnjëri prej eurodeputetëve të sotëm, duke gjykuar nga profilet në Parlamentin Evropian dhe aktiviteti i deritanishëm, nuk ka aftësitë e një ndërmjetësi të regjuri dhe të guximshëm në situata të ndërlikuara me tension të skajshëm. Sikurse i kishte Zëvendës-Ndihmës Sekretari i Shtetit të SHBA-ve për Evropën dhe EuroAzinë, Hoyt Brian Lee, një njohës i shkëlqyer i mendësisë ballkanike dhe i pajisur me një kurajo për t'i thënë gjërat troç dhe realizuar presionin e duhur, i shkollës së ndërmjetësi amerikan me famë botërore Riçard Hollbruk, i mbiquajtur "buldozeri", pasi sheshonte mosmarrëveshje ballkanase politike dhe etnike edhe qindvjeçare,



Perëndoi koha e ish-Kryeministrit austriak Franc Vranicki, që qëndroi një javë në Shqipëri në mars 1997, duke biseduar me politikanët tanë, dy muaj pasi kishte lënë detyrën si kryeministër. Asnjëri prej eurodeputetëve të sotëm, duke gjykuar nga profilet në Parlamentin Evropian dhe aktiviteti i deritanishëm, nuk ka aftësitë e një ndërmjetësi të regjuri dhe të guximshëm në situata të ndërlikuara me tension të skajshëm. Sikurse i kishte Zëvendës-Ndihmës Sekretari i Shtetit të SHBA-ve për Evropën dhe EuroAzinë, Hoyt Brian Lee, një njohës i shkëlqyer i mendësisë ballkanike dhe i pajisur me një kurajo për t'i thënë gjërat troç dhe realizuar presionin e duhur, i shkollës së ndërmjetësi amerikan me famë botërore Riçard Hollbruk, i mbiquajtur "buldozeri", pasi sheshonte mosmarrëveshje ballkanase politike dhe etnike edhe qindvjeçare,

qetësoi furtunën në Maqedoni në pranverën e dy viteve më parë dhe solli drejt marrëveshjes në prill-maj 2017 shumicën dhe pakicën tonë politike, mes të cilave qëndronte një çadër revolucionare. Po sot? Sot opozita ngjan shumë më e distancuar nga jeta normale politike dhe më e vendosur në shqetësim dhe konfliktit dhe serialit të ri të protestave me shumicën qeverisëse. Duket sikur ka shumë pak për të humbur. Ka ardhur në fund të një rruge të gjatë dhe të lodhshme dështimesh. Është më pranë dëshpërimit dhe mungesës së perspektivës politike, nga sa ishte dy vjet më parë. Dhe dihet

forca e dëshpërimit, brenda një strukture partiake që edhe në të shkarën nuk i kanë munguar veprimet e dhunshme. E motivuar nga një perspektivë e raporteve të paqarta të drejtuesve të saj me organet e reja të reformës në drejtësi, të mbizotërues nga ekspertët ndërkombëtarë. Të gjitha këto arsye janë fryrë dhe acaruar, gati në shpërthim frike dhe inati njëkohësisht. Është kjo forcë e ngjeshur dëshpërimit që alarmon të madh e të vogël në këtë vend. Me një potencial prej Neroni për të shkretuar Shqipërinë. Prandaj dhe jo pak prej nesh pyesin: "Do të kemi një buldozer të dytë për krizën sh-

qiptare?". Ambasada e SHBA-ve në Tiranë ka reaguar fort ndaj protestës së dhunshme të 16 shkurtit. Edhe në nivele të vendim-marrësve të politikës amerikane në rajon është i pranishëm shqetësimi për situatën tek ne. Por deri tani nuk duket në horizont një misionar në nivelin dhe kapacitetet e Yee-së të para dy viteve, që të ndërjegjësojë dhe mbajë përgjegjësi palët në përballje. Shpresojmë të mos jetë e nevojshme dhe gjakrat këtu të qetësohen gradualisht. Por si zori, pse atmosfera është e tejmbushur, njëllaj si një det i turbullt përpara furtunës.

## HOROSKOPI

### DASHI

Nuk është e nevojshme të nxitoni për në punë. Përveçse do të qëndroni pak më gjatë aty, ka gjasa që të përballeni me disa shqetësime në familje. Sa u përket financave, dita do të jetë e mbarë, pasi do të arrini të kaloni disa vështirësi.

### DEMI

Do të ishte mirë t'i përkushtoheshit vetes suaj. Paraqitini idetë "me shpirt", duke dhënë më të mirën e mundshme. Rekomandohet të përfshiheni seriozisht në sport. Përpikuni të mos përfshiheni në debat me një prej kolegëve tuaj.

### BINJAKET

Disa Gaforre do ta kalojnë ditën lehtësisht. Priten arrijtë në karrierë, biznes dhe dashuri. Megjithatë, shkalla e këtyre arrijtjeve nuk do të jetë e madhe. Mund të nisni një projekt të ri në kolektiv, rezultati i të cilit do të jetë produktiv.

### GAFORJA

Gaforret këshillohen që ta përzgjedhin me kujdes informacionin që do t'u vijë. Gjërat mund të mos jenë ashtu siç dukën. Mos u përpuni të bëni piis imazhin e dikujt që e konsideroni konkurrent. Do të ishte e udhës të ecnit përpara me sinqeritet.

### LUANI

Shumë Luanë do të kalojnë momente mjaft të bukura sot. Ka gjasa të merrni një surprizë të këndshme. Nuk rekomandohet të shpenzoni më shumë se buxheti tuaj. Mbi të gjitha mos shpenzoni për të blerë artikuj të panevojshëm.

### VIRGJERESHA

Të lindurit e kësaj shenje nuk rekomandohet të ndërmarrin trezime. Këtu përfshihet çdo lloj rreziku, duke përfshirë edhe një takim të mundshëm. Do të ishte mirë ta kaloni ditën në qetësi dhe të vëzhgoni me kujdes disa dokumente të rëndësishme.

### PESHORJA

Kjo ditë për Peshoret mund të jetë ndër më të lumturat. Ka gjasa që të arrini sukses të madh në marrëdhëniet profesionale. Sa i përket marrëdhënies suaj romantike, do të kaloni momente të pahurueshme.

### AKREPI

Do të jetë një ditë me fat, por mos i vështirësoni gjërat duke u treguar skeptik. Besojini intutës, shmangni ankthin dhe kontaktoni me persona që nuk janë besnikë. Në mbrëmje përpikuni të relaksoheni duke bërë tija çesa duke dalë në mbrëmje me personat tuaj të dashur.

### SHIGJETARI

Mos humbni energjinë për gjëra të parëndësishme. Duhet të altermoni punën me pushimin. Ka gjasa të arrini një marrëveshje të rëndësishme në biznes. Sa u përket marrëdhënies personale mund të përballeni me ankth.

### BRICJAPI

27 shkurti do të jetë një ditë me plot surpriza të këndshme sa u përket marrëdhënies personale. Përpikuni të konsolidoni suksesin. Bëni kujdes nga një rrezik iu methojnë, pasi dikush që e konsideroni mik mund të jetë xheloz ndaj jush.

### UJORI

Shmangni kurajën e tepërt sot. Mos u bëni pjesë e një konflikti dhe mos kritikoni familjarët. Në mbrëmje do të zhvillonin një bisedë shumë të rëndësishme me partnerin/partneren tuaj. Ka gjasa që të ndërmerrni edhe një hap vendimtar.

### PESHQIT

Ka gjasa që kjo ditë mos të shkojë ashtu sikurse ju do të dëshironi. Mund të përballeni me probleme në disa çështje biznesi. Mund të shqetësoheni nga indiferenca e partnerit/partneres suaj.

**Mbrojtësi i Kombëtares**

Mërgim Mavraj ka qenë gjithmonë një emër i njohur në futbollin gjerman, që nga debutimi i tij i hershëm me Darmstadt. Por, kulmin e karrierës ai e arriti në radhët e Këlnit, ku brenda pak kohësh u kthye në një nga mbrojtësit më të



**Mavraj, kundër së shkuarës: Nuk kemi frikë askënd**

mirë të Bundesligës, duke u zgjedhur shpesh në formacionin e javës, ndërsa shtyu Hamburgun të blinte kartonin e tij. Këtë javë, Mavraj do të ketë si rivale pikërisht ish-skuadrën e tij, një sfidë ndaj një ekipi që pretendon ngjytjen, ndërsa Ingolstadt lufton

për mbijetesë. Por, Mavraj nuk i trembet këtij fakti, pasi mendon se ekipi është përmirësuar ndjeshëm në krahasim me pjesën e parë të sezonit. "Kemi pësuar më pak gola dhe kjo vjen nga fakti që mbrojmë më të ndërgjegjshëm për atë që bëjmë. Nuk është se pë-

sojmë më pak se ka ardhur një lojtar i ri në ekip", shpjegoi ai sot, duke iu referuar faktit se shumëkush ia atribuon përmirësimin në fazën difensive të ekipit afrimit të Mavrajt në janar. "Nëse do të flas për periudhën time këtu, shoh se tani komunikojmë më shumë dhe mbrojmë shumë më lart dhe më shpejt, që e bën punën tonë më të lehtë".

Sfida ndaj Këlnit është e veçantë, por Mavraj sheh mundësi të mira për të siguruar rezultat edhe ndaj ekipit të dytë në renditjen e Bundesligës 2. "Askush në skuadër nuk është i frikësuar nga ndeshja e radhës. Përveç kësaj, ne besojmë se mund të përshtatem me mirë me mënyrën se si luajnë ata", ishte bindja e Mavrajt.

Federata vijon trendin e ndëshkimeve të buta, teksa më herët vetëm pati gjobitur goditjet ndaj anësorëve

**Disiplina dënon Partizanin, por nuk cënon derbin me Tiranën**

*Dhuna ndaj fotografit, të kuqtë 2 ndeshje pa tifoze*

Jeton Selimi



Derbi i kryeqytetit do të ketë të pranishme të dyja tifozëritë. Komisioni i Disiplinës ka dënuar me dy ndeshje pa tifoze Partizanin për mospërbushjen e përgjegjësi në ndeshjen ndaj Flamuritit. Gjithsesi, bëhet fjalë për dy takime, të cilat Partizani do t'i luajë si skuadër pritëse, kështu meqenëse në derbin e kësaj të premtjeje është Tirana skuadra pritëse, në stadiumin "Selman Stërmasi" do të jenë edhe tifozët e kuq, si fansa të skuadrës mike. Ja ka hedhur paq Partizani me vetëm dy ndeshje pa tifoze dhe për sulmin që një grup fansash të Partizanit i bënë fotografit të Flamuritit në momentin e shënimit të golit nga ana e vlonjatëve. Ja dhe vendimet e plota të Komisionit të Disiplinës të mbledhur djete më datë 26 shkurt 2019, ku spikat edhe pezullimi me 4 ndeshje i Albano Aleksit të Luftëtarit.

**VENDIMET**

1. KF "Luftëtari", për sjellje të gabuar të spektatorëve, në bazë të Nenit 66/1 të KDS, dënohet me gjobë në masën 100.000 (njëqindmijë) lekë .
2. Lojtari i KF "Luftëtari", Albano Aleksit, për sjellje jo sportive ndaj zyrtarit të ndeshjes, në bazë të Nenit 49/1/a të KDS, dënohet me 4 (katër) ndeshje pezullim nga aktiviteti.

3. KF "Skënderbeu", për sjellje të gabuar të spektatorëve, në bazë të Nenit 66/1 të KDS, dënohet me gjobë në masën 100.000 (njëqindmijë) lekë.
4. KF "Tirana", për sjellje të gabuar të spektatorëve, në bazë të Nenit 66/1 të KDS, për

shkak të përsëritjes së shkeljes, dënohet me gjobë në masën 400.000 (katërqind mijë) lekë.

5. FK "Partizani", për dëshitim në përbushjen e përgjegjësi për organizimin e ndeshjes kundër "Flamuritit" FC duke mos garantuar sigurinë e zyrtarit të ekipit

kundërshtar, në bazë të Nenit 64(b)/c/e); 65/1 dhe 65/2 të KDS, dënohet me zhvillimin e 2 (dy) ndeshjeve pa spektatorë në stadiumin përkatës si dhe gjobë në masën 200.000 (dyqind mijë) lekë.

6. KS "Kastrioti", në bazë të Nenit 13 të KDS, paralaj-

jmërohet se në rast përsëritje të shkeljeve disiplinore, do të jetë subjekt i ndëshkimeve që parashikon Kodi i Disiplinës Sportive dhe rregulloret e tjera të FSHF.

7. Zyrtari i KF "Shënkollit", Armando Loka, për sulm ndaj zyrtarit të ndeshjes, në bazë të Nenit 49/2/b) të KDS, dënohet me 18 (tetëmbëdhjetë) muaj pezullim nga çdo aktivitet futbollistik.

8. Lojtari i KF "Shënkollit", Rinev Danaj, për dhunë ndaj zyrtarit të ndeshjes dhe për shkelje disiplinore të përsëritur gjatë periudhës së provës, në bazë të nenit 49/2/b) të KDS, dënohet me përjashtim të përhershëm nga çdo aktivitet futbollistik.

9. Pranimin e kërkesës së lojtarit të KF "Partizani" U-19, Joan Çela dhe pezullimin e pjesës së mbetur të dënimit. Në bazë të Nenit 33/4 të KDS, lojtari Joan Çela vendoset në provë për një periudhë 6-mujore.



**DERBI I KRYEQYTETIT**

Tirana ndan tribunat, policia shkëmben tifozët në tribunën qendrore

Nuk ka më asnjë dyshim për sektorët ku do të akomodohen tifozët e Partizanit në "Selman Stërmasi" për derbin me Tiranën, ku klubi bardheblu është organizator i kësaj supersfide. Drejtuesit e Tiranës kanë vendosur që tifozët e Partizanit të kenë në dispozicion tribunën kryesore A dhe atë anësore H, pra të gjithë fansat e kuq do të jenë të vendosur në të njëjtin krah, duke shmangur kështu fragmentarizimin në akomodimin e tifozëve, që mund të sillte edhe përplasje mes dy tifozërive. Ndërkohë të gjithë tifozët e Tiranës do të vendosen në tribunat B, C, D, E, F, G. Tifozët e Tiranës, që kanë abone, për tribunën A do të kontaktohen nga kompania që menaxhon biletat për të ruajtur të njëjtat vende në tribunën B. Tifozët e kuq mund t'i marrin biletat e tyre nga dita e mërkurë. Me këtë ndarje, tifozët e Partizanit do të kenë në dispozicion të tyre më shumë se 20% të kapacitetit të "Selman Stërmasit". Çmimet e biletave variojnë nga 2000 lekë në tribunat A dhe B, në 400 lekë në të gjithë sektorët e tjerë.

**ISH-TRAJNERI KUQEZI**

**De Biazi: Ikardi mund të kthehet në një minë me sahat**

Xhani De Biazi ndjek gjithmonë me shumë kujdes ngjarjet të skuadra e Interit. Ish-trajneri i përfaqësueses shqiptare ka qenë në të kaluarën e tij futbollist në radhët e zikaltërve dhe shpesh është përmendur si një prej emrave më të mundshëm për të marrë drejtimin e zikaltërve nëse do të kërkohej një teknik i përkohshëm. Normalisht, as De Biazi nuk i është shmangur dot temës më të nxehtë të



ditëve të fundit, asaj të Mauro Ikardit dhe të ardhmes së tij tek Interi. Sipas ish-trajnerit të ku-


qezinje, kjo situatë duhet të zgjidhet sa më shpejt, për të evituar që të përkallëzohet më tej. "Nëse çështja "Ikardi" do të menaxhohet mirë, ashtu siç mendoj, mund të ketë një qartësim në domat e zhveshjeve të Interit. Përndryshe rrezikim të kthehet në një minë me sahat. Personalisht shpresoj që të paktën të shuhen projektorët mbi familjen e futbollistit", deklaroi ai.

**VERILINDORËT**

**Shkurtaj thyen dorën, Kukësi hap dyert e stadiumit për tifozët**

Kukësi dhuroi një spektakël ofensiv në sfidën kundër Kamzës, Shkurtaj, Rama dhe Rroca arritën të gjenin rrugën e rrjetës, tre lojtarë të afruar gjatë merkato së janarit, një arsye më shumë për të festuar atë trepikësh që i mban ende në valle për titullin kampion. Verilindorët shpresojnë shumë që Partizani të ndalet në derbin e kryeqytetit, por më parë duhet të bëjnë saktë detyruar e shtëpisë, të mposhtin Luftëtarin. Pavarësisht se ndaj Kamzës siguruan fitoren, dukshëm Kukësi ishte një ekip i prekshëm, pësuar dy gola, kjo e kush-tëzuar dhe nga mungesat e shumta, mbi të gjitha në mbrojtje. Vasil Shkurtaj shënoi golin e tij të parë në kampionat me fanellën e Kukësit, por ai takim i solli një frakturë në gishtin e njëjës dorë. Dënimi nuk është në shkallën e brazilianit Kordero, një tjetër mungesë si pasojë e frakturës në dorë, gjithsesi gjendja e vlonjatit do të monitorohet edhe në ditët në vijim.

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

- Hari spiune.
- Janë toksike.
- Gjysmë arrest.
- Janë vende pa ne.
- Johnny i Donnie Brasco.
- Priten nga meridiane.
- Me të nxjerrin një letër.
- U verbua nga Askushi.
- Një britmë në arenë.
- Shkrimtari i J'accuse.
- Si moral.
- Nota e diapazonit.
- Me dies në një liturgji.
- Një mund të jetë edhe veprimi.
- Eshtë e re pas Krishtit.
- Inicialet e Bergman aktore.
- Ai i trëndafilit është i Umberto Eco-s.
- Fise pa fe.

- Një provë zjarri.
- Eshtë mjeshtri me... baketë.
- Digjen po nuk u zbuluan.
- Iglli të Lazio.
- Kush del... mbështet.
- Mund të jetë unik.
- Ngrihen për atentate.
- Janë fjetore në kazerma.
- Altini mesfushor.

**VERTIKAL**

- Fillojnë matanë.
- Një Hans artist dadaist.
- Eshtë mjet rrethor lundrimi.
- Eshtë ënjtje.
- Lumi i Elizit.
- Fillojnë mpijren.
- Eshtë e gjithë Hëna.
- Eshtë qetësues për neurozat.
- Taylor aktore.
- Daniel i Robinson Crusoe.
- Kështu janë skenat që mallëngjejnë.
- Eshtë pjesë në skenë.
- Lëvizje Ekologjike Lokale.
- Përshkohej nga Leti.
- Eshtë muzika më e... kollajtje.
- Grazia Cucinotta aktore.
- Veriu pa ekstreme.
- Janë tre në trickick.
- Scola, regjisor italian.
- Kufizojnë një metër.
- Mbahet me inat.
- Mbyllin kurse.
- Ka një shpejtësi fantastike.
- Laik kur s'është ai.
- Një liqen i kripur.
- Një mund të jetë fetar.
- Eshtë lloj papagalli.
- Në hyrje të sallës.
- Priten në skaje.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


- Janë lokale me kubiste.
- Me të nxjerrin në tapë.
- Polanski regjisor.
- Qeni i famshëm i Odiseut.
- Mbeten në fund.
- Gabon në ekstreme.
- Rreh në kufij.
- Eshtë vepër për një... vepër.
- Janë udhëtime për një vend të shenjtë.
- Dinë shumë gjuhë.
- Një mendim.
- Famëkeqi Capone.
- Kush i kthen... të braktis.
- Kisha pa zë.
- I fuqjari i kukullës Barbie.
- Ritet pa re.
- Një brinjë në skuadër.
- Emri i Zola.

**VERTIKAL**


- Barrymore aktore.
- Tiriac që te tenist.
- Kisha pa zë.
- Eshtë kleri me papën.
- Ndezur në aparaturë.
- Kaluar në krye.
- Janë racë e pastër.
- Një treg pa re.
- Duhen fituar me djersë.
- Një dritë për sake.
- Lëvizin pasi mendohen shumë.
- Janë sfera për bingo.
- Eshtë më pak se nxehtësi.
- Gibson aktor.
- Tregonin skilevër dikur.
- Mund të jenë fetare të tilla.
- Kush nuk ka... nuk i ecën.
- Një sherr në shtyp.
- Një lidhëz.
- Mund të jenë cigaresh.
- Mund të bëjë zoom.
- Ndërmarrje Industriale Mirditë.
- Pak konkrete.
- Eshtë i mirë me shokë shumë.
- Artikull për shumë francezë.
- Kanto kur nuk... ka.
- Muzika me jam session.
- Mbyllin një sherr.
- Të fundit në sirtar.




**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



**Argëtim filozofik**

- Për pjesën tjetër të botës jeni vetëm një person, por për mua, jeni e gjithë bota.
- "Dicka duhet të bëj" gjithmonë zgjidh më shumë probleme sesa "dicka duhet të bëhet".
- Problemi më i madh i komunikimit, është se, nuk dëgjojmë për të kuptuar, por për t'u përgjigjur.
- Truri ndahet në dy pjesë: e ëndrrave dhe e nevojës. T'i je në mes, sepse je ëndërra që e kam nevojë.
- Ndjeni keqardhje për të pasurit: në qoftë se i ruajnë paratë e tyre, konsiderohen dorështrenëguar, në qoftë se shpërdorojnë për veten e tyre, egoistë, dhe nëse i ndajnë me të varfërit, budallenj.

**Thënie të mençura**

- Garat politike në 25 vjetet e fundit kishin të bënin me shpërndarjen e barabartë të vezeve të arta. Në dekadat e ardhshme ne duhet të përqendrohemi në shëndetin e patave.
- Premtimi i dhënë ishte një domosdoshmëri e së kaluarës. Arsyja se pse nuk është mbajtur, është një domosdoshmëri e së tashmes.

**SUDOKU**

4			2	1					
		6							3
5							2		
8			1	6					
6							4		
		3							5
3						4			
	2	1			4			8	
	9		2	8					

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9



**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

1	7	3	5	8	9	6	2	4
2	8	5	4	6	3	7	9	1
6	4	9	1	7	2	3	5	8
3	9	2	6	1	7	8	4	5
4	6	7	8	2	5	9	1	3
5	1	8	3	9	4	2	6	7
7	2	1	9	5	8	4	3	6
8	5	4	2	3	6	1	7	9
9	3	6	7	4	1	5	8	2

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm



- Nëse zoti është me ju, nuk ka rëndësi se kush është kundra jush.
- Për disa njerëz e futni dorën në zjarr se nuk do t'ju shesin kurrë, dhe në fund gëzoheni se keni dhe një tjetër.

